

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Dhoma e Noterise Tirane

N~~o~~ 854 Rep. N~~o~~ 1567 Kol.



Akt Kalim i Pronesise mbi Aksionet

Sot me 29 / 05 / 2009 u paraqit para meje notere Luljeta Kongoli ne Rrugë Kont Urani, prane ish-gjykates, pala e meposhtme:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjikës ne Republiken e Shqiperise ne emer dhe per llogari te Republikes se Shqiperise, perfajesur ne menyre te rregullt nga Z. Genc Ruli, i birl i

Pellumbi dhe Fatme, lindur me 11.04.58, ne
Tiranë, banues ne Tiranë, qytatar shqiptar madhor me zotesi te plotë veprimi (me poshtë referuar si Shitesi)

i cili ma kerkon redaktimin dhe perfundimin e ketij Akti si me poshtë:

Subjekti: Marreveshja e Blerjes se Aksioneve ndermjet Republikes se Shqiperise dhe CEZ A.S. date 11 Mars 2009

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjikës duke vepruar ne emer te Republikes se Shqipense ("Shitesi") dhe CEZ A.S. ("Bleresi") kane hyre ne 11 Mars 2009 ne një Marreveshje te Blerjes se Aksioneve ("Marreveshja e Blerjes se Aksioneve") per marrjen e pronesise nga Bleresi te nje numri aksionesh ne Operatorin e Sistemit te Shperndarjes sh.a. ("OSSH") qe perfaqeson 76 % te te gjithe kapitalit aksioner te OSSH.

Sipas Marreveshjes se Blerjes se Aksioneve Shitesi do te dorezoje ne Daten e Mbylljes kete akt te mbylljes prezente ("Certifikata e Mbylljes se Shitesve").

Fjalet qe fillojne me shkronja te medha te perdorura ne kete Certifikate te Mbylljes se Shitesve do te kene te njejtin kuptim te parashtuar ne Marreveshjene e Blerjes se Aksioneve.

Shitesi, me ane te ketij Akti:

- Konfirmon se te gjitha kushteve paraprake parashtuar ne nen 4 te Marreveshjes se Blerjes se Aksioneve jane permbugur dhe prandaj ne permbugje te detyrimit te tij sipas Marreveshjes se Blerjes se Aksioneve, Shitesi, qe nga data e ketij akti transferon, ariubon, dhe dorezon tek Bleresi 22.875.317 aksioneve ne kapitalin e OSSH te cilat qe sot perfaqesojn 76 % te te gjithe kapitalit aksioner te OSSH.
- Autorizon Qendren Kombetare te Regjistrimit te regjistroje ndryshimin e pronarit te 76 % te aksioneve ne OSSH ne perputhje me pikën (a) me siper,
- Konfirmon se Shitesi ka kthyer tek Bleresi Sigurimin e Ofertes dhe se Shitesi nuk ka pretendime ne lidhje me Sigurimin e Ofertes. Cdo pretendim i Shitesit sipas Sigurimit te Ofertes do te konsiderohet i shuar.


Une noterja pasi lexova me ze te larte kete akt, Shitesit dhe pasi e gjeta ate ne perputhje me vullnetin e tij te lire, noterizova kete akt ne perputhje me Ligjin.

Per dhe ne emer te Shitesit:

111840261



Noterja:



Registry of Shares of Operators i Sistemi te Shperndarjes (OSSH) (the "Company")

Date of the Registration	Shareholder	Shareholder's Address / legal seat	Number of shares in the Company	Contribution	Nominal Value of the shares
Data e regjistrimit	Aksioneri	Adresa e Aksionerit / Zyra Ligjore shqeri	Kontributi i paguar	Vlera nominale e aksioneve	
29 May 2009	CEZ A.S.	Duhová 2/1444, Praha 4, postcode 140 53, Czech Republic	22,875,317	22,875,317,000	ALL 1,000
29 May 2009	Republic of Albania acting through its Ministry of Economy, Trade and Energy	Blv Deshmoret e Kombit 1001, Tirane, Shqiperi	7,223,784	7,223,784,000	ALL 1,000

Drejtori i Pergjithshem




 Z. Saiti Dollapi

Regjistri i Aksioneve te shqerise Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH) ("Shoqeria")

Date of the Registration	Shareholder	Shareholder's Address / legal seat	Number of shares in the Company	Contribution	Nominal Value of the shares
Data e regjistrimit	Aksioneri	Adresa e Aksionerit / Zyra Ligjore shqeri	Kontributi i paguar	Vlera nominale e aksioneve	
29 May 2009	CEZ A.S.	Duhová 2/1444, Praha 4, postcode 140 53, Czech Republic	22,875,317	22,875,317,000	ALL 1,000
29 May 2009	Republic of Albania acting through its Ministry of Economy, Trade and Energy	Blv Deshmoret e Kombit 1001, Tirane, Shqiperi	7,223,784	7,223,784,000	ALL 1,000

General Director




 Z. Josef Hejsek




 Z. Josef Hejsek



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHESHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

URDHER

Nr. 480, date 29.5. 2009

**PËR TRANSFERIMIN E 76% TE AKSIONEVE NE SHOQERINE OPERATORI I
SISTEMIT SHPERNDARJES SH.A.**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe te ligjit nr.10 116, datë 23.4.2009 "Per miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së republikës së shqipërisë dhe CEZ a.s.-së" :

URDHËROJ:

Transferimin nga pronesia e Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjetikës si perfaqësuese e Republikës së Shqiperise ne pronesi te shoqerise CEZ A.S. te 22.875.317 aksioneve te zakonshme ne Operatorin të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha qe perbejne 76 % te kapitalit aksioner te kesaj shoqerie.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

GENC RULI

Adresa: Blvd."Deslumoret e Kombit" Nr.1001
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 227617
Fax: +355 4 234052





FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.60

14 maj

2009

PËRMBAJTJA

Faqe

Liqj nr.10 116
datë 23.4.2009

Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve
të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.-së
ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së
Republikës së Shqipërisë dhe ÇEZ a.s.-së 2645

LIGJ
Nr. 10 116, datë 23.4.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ÇEZ A.S.-SË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e shitjes së 76 për qind të akioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërendarjes (OSSH) sha-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe ÇEZ A.S.-së, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Aksionet e OSSH sha-së, objekt i kësaj kontrate shitjeje, të cilat janë në pronësi të shitetit shqiptar, të lira nga çdo barrë, në ditën që bëhet efektive kontrata e shitjes, i kalojnë në pronësi ÇEZ A.S.-së, të lira nga çdo barrë.

Neni 3

Asitet, që janë në pronësi të OSSH sha-së c që janë pasqyruar në unekset e kontratës së shitjes së akioneve do të vazhdojnë të janë në pronësi të OSSH sha-së në masën dhe mënyrën e përcaktuar në çastin e nënshkrimit të kontratës, edhe pas transferimit të pronësisë së akioneve te ÇEZ A.S.-ja.

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, OSSH sha-së i jetet titulli i plotë i pronësisë mbi të gjitha asetet kryesore, të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së këtij operatori.

Neni 4

OSSH sha-ja do të vazhdojë të gjëzojë të drejtat e servituit për përdorimin e aseteve në pronësi të saj dhe për ushtrimin e veprimtarisë së shpërendarjes e të furnizimit me energji elektrike.

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, OSSH sha-ja fiton të drejta të plota ligjore, si përfituese e servituteve të nevojshme për përdorimin e pronave kryesore të paluajtshme dhe ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 5

Pika 10 e vendimit nr.338, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", të ndryshuar, i shtrin efektet deri në datën e transferimit të akioneve nga shteti shqiptar te ÇEZ A.S.-ja dhe asitet, të drejtat e detyrimet e përcaktuara në pikat 5 paragrafi i dytë, 5/3, 5/4 e 5/5 të vendimit nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërendarjes" sha", të ndryshuar, u përkasin dhe do t'u transferohen entiteteve të përcaktuara në këtë vendim.

Neni 6

Republika e Shqipërisë do të zhdëmtojë OSSH sha-në dhe ÇEZ A.S.-në, sipas rastit, për çdo dëm, humbje dhe kosto, që rezulton nga çdo shkelje e huamarrësit, domethënë të Republikës së Shqipërisë dhe/ose KESH sha-së, apo, në rast të mospërbushjes (përfshirë këtu pa kufizime përshpejtimin përi ripagimin e kredisë, ndërprerjen e saj, të kostos dhe penalitetet përkatëse), sipas çdo marrëveshjeje financimi afatgjatë, në lidhje me veprimtarinë e shpërndarjes, që i bashkëlidhet marrëveshjes përi ripagimin afatgjatë të borxhit ndërmjet KESH sha-së dhe OSSH sha-së, të parashtruar në shtojeën informuese ("Marrëveshja e RAB-it") dhe për çdo dëm, humbje apo kosto, që vjen si pasojë e shkeljes nga KESH sha-ja të marrëveshjes së ripagimit afatgjatë të borxhit, si dhe përi çdo dëm, humbje dhe kosto, që rezulton nga pavlefshmëria joefektive apo mosbatueshmëria e çdo akti ngjarjeje, të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 7

Parametrat kryesorë, siç përcaktohen në deklaratën rregullatore (që i bashkëlidhet si aneks kontratës së përmendur në nenin 1 të këtij ligji), ruhen të pandryshuara deri në përfundimin e afateve kohore të përaktuara në këtë deklaratë.

Neni 8

Aktet normative përkatëse përi falimentimin nuk do të zbatohen ndaj OSSH sha-së, në rast se gjatë periudhës së falimentimit kreditdhënësit e KESH sha-së do të kundërshtonin kontributin, që kjo e fundit ka bërë në OSSH sha-në, në formën e kapitalit në natyrë dhe/ose transferimin e aksioneve nga KESH sha-ja te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe/ose transferimin e aseteve e të detyrimeve, të përaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 9

Për efekt të përaktimit të borxhit të keq të OSSH sha-së dhe, në veçanti, përfekt të shkronjës "c" të nenit 24 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe të nenit 34 të ligjit nr.7938, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, njohja nga Enti Rregulator i Enerjisë i nivelit të borxhit të keq, përfekt të llogaritjes së tarifës së shijes së energjisë elektrike te konsumatorët fundorë, vlerësohet si provë se shoqëria ka ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm ligjorë përkthimin e tij dhe kjo njohje përcakton nivelin e borxhit të keq, të njohur përfqilli tatimore.

Neni 10

Ky ligj hyr në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6157, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**MARRËVESHIJE
PËR BLERJE AKSIONESH**

DATË 11 MARS 2009

**MIDIS MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË CILËSINË E PËRFAQËSUESIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

[*Shitësi*]

Dhe

ČEZ, a.s.

[*Blerësi*]

MARRËVESHIJE PËR BLERJE AKSIONESH

Kjo Marrëveshje për blerje aksionesh ("MBA") lidhet midis:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri Genc Ruli, i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllim të kësaj Marrëveshje, që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë,

të cilës do i referohemi këtej e tutje si "METE" ose "Shitësi",
dhe

2. ČEZ, a.s., një shoqëri aksionare me kapital aksionalar të emetuar në vlerën CZK 59 221 084 300, me zyrë të regjistruar në Duhová 2/1444, Pragë 4, 140 53, e regjistruar në Regjistrin Tregtar dhe të Shoqërive të Gjykates së Njësisë Administrative te Pragës, nën numrin B 1581, dhe e përfaqësuar nga Z. Vladimir Schmalz, Drejtor i Shkrimtareve dhe Blerjeve, i autorizuar në mënyrën e duhur për qëllim të kësaj Marrëveshje,

të cilës do i referohemi këtej e tutje si "Investitorit Strategjik" ose "Blerësi".

METE-s dhe Investitorit Strategjik, ketej e tutje, do t'u referohemi në mënyrë individuale si "Pale" dhe në mënyrë kolektive si "Palë".

MEQENËSE:

A. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme në sektorin energjetik që kanë për synim liberalizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Janë ndërmarrë një sërë masash për të vënë në zhatim këto reforma përmes krijimit të një tregu konkurrues të energjisë elektrike në përpunje me kërkzesat e Bashkimit të Europës, përfshire këtu ristrukturimin e KESH-it dhe tërheqjen e investitorëve strategjik të këtë sektor përmes privatizimit.

B. METE kërkon që të privatizoje shoqërinë aksionare Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SHA ("OSSH" ose "Shoqëria"), me zyrë të regjistruar në Rrugen: "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri. OSSH-ja kryen aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakicë të energjisë ("Aktiviteti"). Privatizimi i OSSH-së do të realizohet duke i shitur një investitor strategjik nje numer te tillë aksionesh që ne Datën e Mbijtjes të përfaqësosojë shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të kapitalit aksionalar të regjistruar të OSSH-së ("Transaksioni"), të zotëruara nga METE, ("Aksionet"). Me qëllim që të tërheqë vëmendjen e investitorit strategjik optimal për operimin dhe zhvillimin e OSSH-së, METE ka vendosur që të zhvillojë një tender ndërkombëtar të hapur për ekzekutimin dhe nënshkrimin e kësaj MBA-je midis METE-s dhe Investitorit Strategjik.

C. Në 17 Qershor 2008, ofrueshi e parakualifikuar, të deklaruar si të tillë nga METE në vijim të fazës së parakualifikimit, u fuan që të dorëzonin ofertat e tyre për qëllim të Transaksionit.

D. Pas shqyrtimit dhë vlerësimit të çdo oferte, METE shpalli ÇEZ, a.s. si ofertuesin fitues të tenderit dhe si rrjedhojë Investitor Strategjik.

E. Palët kanë vendosur që të lidhin këtë MBA në mënyrë që të vendosin kushtet dhe afatet për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre reciproke në lidhje me Transaksionin

PALËT BIEN DAKORT SI MË POSHTË:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Në këtë MBA (përfshirë këtu pëshkrimet në pjesën hyrëse dhe anekset e kësaj marrëveshje), përvet kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike apo në varësi të kuptimit të tekstit, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e dhënë më poshte:

“Personë të lidhur” do të thotë që Person is cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, pëmës një apo më shumë ndërmjetësish, Kontrollon, Kontrollohet apo i nënshtrohen Kontrollit të përhashkët të një Personi të caktuar;

“Marrëveshje” do të thotë kjo marrëveshje përfshire Anekset që i bashkangjiten;

“Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës” do të thotë Komisioni i Konkurrencës siç parashikohet në nenin 19 të Ligjit shqiptar Nr. 9121 datë 28 Korrik 2003;

“Gjykata e Arbitrazhit” do të ketë kuptimin që i është dhënë në Nenin 13.3;

“Autorizim” do të thotë autorizimet, lejet, licencat, miratimet dhe deklaratat dhe moskundërshtimet ndaj deklaratave, të kërkua nga Investitori Strategjik apo OSSH-ja në mënyrë që të realizojnë Transaksionin;

“Garancia e Ofertës” do të thotë garancia e ofertës që i është dhënë METE-es nga Investitori Strategjik në përputhje me Dokumentat e Tenderit.

“Ditë Biznesi” do të thotë që ditë kalendarike, me përijashtim të të Shumave dhe të Dieieve apo ditë tjetër në të cilën bankat nuk ushtronjnë aktivitetin e tyre të zakonshëm në Tirunë, Shqipëri;

“Ndryshim Kontrolli” do të thotë një ndryshim në lidhje me një shoqëri apo entitet tjetër si rrjedhojë e të cilit Kontrolli në këtë shoqëri apo entitet ndryshon, përfshirë këtu kur Kontrolli ushtronhet nga persona të ndryshëm nga ato që zoterojnë këtë Kontroll në datën e kësaj Marrëveshje apo çdo Ndryshim Kontrolli i mëvonshëm i kryer sipas kësaj Marrëveshje.

“Njoftim Pretendimi” do të ketë kuptimin që i është dhënë në Nenin 8.5.1;

“Mbylli” do të thotë finalizimi i shitjes dhe blerjes së Aksioneve sipas kësaj Marrëveshje si rrjedhojë e përbushjes nga Palët të detyrimeve të tyre respektive.

“Data e Mbylljes” do të jetë data e përeaktuar në Nenin 6.1;

“Vendimi I i KM” do të thotë Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 143, datë 11 Shkurt 2009;

“Vendimi II i KM” do të thotë Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 218, datë 06 Mars 2009;

“Kushtet Paraprake” do të thotë kushtet përmbylli, siç përcaktohen në Nenin 4;

“Kontroll”, në rastet kur i referohet një entiteti, përfshirë këtu një shoqëri, do të thotë kompetenca për të:

- kontrolluar më shumë se një të dytën e fuqisë votuese të shoqërisë apo të një entiteti tjetër;
- kontrolluar përbërtjen e bordit administrativ të shoqërisë apo të një organi drejtues të një entiteti;
- kontrolluar më shumë se një të dytën e kapitalit aksional me të drejtë vote të shoqërisë apo të interesit në kapitalin me të drejtë vote të entitetit; apo
- kontrolluar në forma të tjera administrimin një shoqërie apo të një entiteti tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, pavarësisht nesc:
 - ushtronhet në mënyrë formale apo joformale;
 - ka apo jo efekt sipas ligjit apo apo norme të së drejtës;
 - bazohet mbi një të drejtë të njohur me ligj apo norme të së drejtës; apo
 - ushtronhet, drejtpërsëdrejtë apo tërthorazi, përfshirë këtu përmes një apo më shumë personash apo entitesh.

"Dëm" i referohet qdo dëmi financiar të shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së një deklarimi dhe/ apo garacie, përfshirë këtu shpenzimet e arsyeshme të kryera në perpjekje për të parandaluar dëmin.

"Të Dhëna" do të thotë qdo informacion, qoftë në formë fizike apo elektronike, që Blerësi i jep apo vë dispozicion të Blerësit ose agjentëve, përfaqësuesve apo këshilltarëve të tij, në lidhje me Transaksionin e parashikuar në këtë MBA, përfshirë këtu dokumentat e data room si dhe memorandumin informativ që i është dhënë Blerësit, me përjashtim të Raportit të KPMG-së;

"Shtojca Informuese" do të thotë shtojca që i bashkangjitet kësaj Marrëveshje si Aneksi 12, dhe që jep informacionin që përbën deklaratat dhe garancitë e Shitësit, siç parashikohet në vijim;

"Barrë" do të thotë çdo interes ose pjesmarrije në kapital të qdo personi (përfshirë qdo të drejtë për të blerë, opsim apo të drejtë parablerje) apo qdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kalm të drejtash, kufizim, barrë siguruese (përfshirë ato të krijuara me ligj), titull me rezervë apo marrëveshje ose transaksione të tjera siguruese, apo dhënic me qera, blerje me leasing, shitje me kredi apo marrëveshje të tjera ku parashikohet që pagesa të kryhet në kohë të ndryshme;

"Raporti Mjedisor" do të thotë raporti mbi kushtet mjedisore që duhet të plotësohen nga OSSH-ja, raport ky i përgatitur nga SNC Lavalin, i datës Maj 2008, dhe që bashkangjitet këtu si Aneksi 5;

"ERE" do të thotë Enri Rregulator i Energjise Elektrike në Shqipëri;

"KESH" do të thotë Korporata Elektroenergjite Shqiptare, shoqëria shqiptare e prodhimit të energjisë, përfshirë trashëguesit e saj dhe personat të cilëve u janë kaluar të drejtat e saj;

"Raporti i KPMG-së" do të thotë Raporti i Ekspertëve Kontabël të Pavarur i datës 18 Gusht 2008, i përgatinur nga KPMG-ja;

"Llogaritë e Fundit" do të thotë pasqyrat financiare të kontrolluara të OSSH-së për vitin e tij financiar të mbyllur me datë 31 Dhjetor 2007 dhe të përgatitura në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar ("IFRS").

"Legjislacion" do të thotë çdo akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo ligj tjeter (përfshirë Legjislacionin përmjedisin) rregullore ose statut apo çdo rregull, kod, direktivë apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo personi të krijuar me ligj. (qoftë apo jo autonom), që ka juridiksonin përkatës, për sa kohë që është publikuar apo publikisht i aksesueshëm, dhe subjekt i vendimeve të gjykatave dhe trupave gjykuar të ndryshëm të Republikës së Shqipërisë, vendimeve dhe akteve të ministrave, qarkulloreve të departamenteve, si dhe deklaratat dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë që kanë juridikson mbi çështjen në fjalë; përfshirë ndryshimet e herëpasbershme të tyre;

"Liqencë" do të thotë liçenca e shpërndarjes së energjisë elektrike, liçenca e furnizimit me pakicë të energjisë elektrike dhe çdo liçence tjeter që është marrë apo që do të merret nga Rregulatori për zbatimin dhe realizimin e aktivitetit të OSSH-së;

"Llogaritë e Menaxhimit" do të thotë pasqyrat financiare majore të pakontrolluara, të OSSH-së, gjatë periudhës që fillon me 1 Janar 2008 dhe mbaron me 31 Dhjetor 2008, të përgatitura në përputhje me Parimet e Përgjithshme të Mbajtjes së Llogarive ("GAAP") vendase;

"Ndryshim Thelbësor Përkeqësues" do të thotë çdo ngjarje që shkakton apo ka arsyë për të menduar që do shkaktojë një ndryshim thelbësor me pasojë përkeqësuese mbi aktivitetin dhe asetet e OSSH-së dhe si rezultat i të cilit OSSH-ja apo Blerësi pësojnë një humbje vlera e së cilës e tejkalon shifrën dbjetë million Euro (10.000.000 EUR), përfshirë këtu pa kufizim ngjarjet që vijojojnë: humbja e një numri të konsiderueshëm klientësh, çdo ndryshim thelbësor në kuadrin rregulator në Shqipëri siç përuaktohet në Deklaratën Rregulatorore që bashkangjitet këtu, heqja dorë, fshirja ose ndryshimi i një Liçence apo deklarimi i gjendjes së paafësisë paguese ose i likuidimit të OSSH-së nga një gjykatë kompetente;

"Qëndra Kombëtare e Regjistrimit" do të thotë subjekti administrativ i krijuar sipas Ligjit Nr. 9723, datë 03/04/2007, "Mbi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

"Vëzhgues" do të ketë kuptimin që i është dhënë në Nenin 5.3.4;

"Person" do të thotë një individ, shoqeri aksionare, shoqeri me përgjegjësi të kufizuar, ortakeri, shoqatë, fondacion, trust apo entitet ose organizatë tjeter që gjëzon personalitet ligjor, përfshirë qdo Autoritet Qeveritar;

"Periudhë Para-Mbylljes" do të thotë periudha nga Data e Nënshkrimit, përfshirë këtë datë, deri në Datën e Mbylljes, përfshirë këtë date;

"Qmimi i Blerjes" do të ketë kuptimin që i është dhënë në Nenin 3.1;

"Grupi i Blerës" do të thotë Blerësi dhe të gjithë Personat e Lidhur me të;

"Ligi Ratifikues" do të thotë ligji i përcaktuar në Nenin 4;

"Vlera Referuese Neto e Aseteve" do të thotë totali i aseteve të OSSH-së pasi t'i janë zbritur çdo detyrim, i përgatitur në përputhje me IFRS dhe bazuar në Llogaritë e Fundit;

"Rregulator" do të thotë ERE (Enti Rregulator i Sektorit të Energjisë Elektrike) (Autoriteti Shqiptar Rregulator i Energjisë Elektrike) apo qdo rregulator tjeter ose deparament, organ, agjenci apo autoritet rregulator i industrisë së energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë apo të qdo nëndarje të saj të krijuar mbi bazën e Legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, që ka autoritetin të miratojë tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, të lëshojë licenca dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet midis të licencuarve si dhe midis të licencuarve dhe klientëve të tyre;

"Deklaratë Rregulator" është deklarata me efekt rregullativ e lëshuar nga Rregulatori në 3 Mars 2009, bashkangjitur këtu si Aneksi 11;

"Aksione" do të ketë kuptimin që i është dhënë në përshtimin në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

"Data e Nënshkrimit" do të thotë dita në të cilën është nënshkuar kjo Marrëveshje nga të dy Blerësi dhe Shitësi, siç paraqitet në faqet e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje;

"Taksat" apo "Tatimi", do të thotë të gjitha llojet e barrës fiskale dhe takave në Shqipëri, tarifave doganore dhe detyrimeve të tjera të natyrës fiskale, përfshirë interesat, gjohat apo detyrimet e tjera të lidhura, të pagueshme ndaj apo të ngarkuara nga një autoritet tatimor, doganor, etj si dhe të gjitha kontributet për sigurimet shoqërore dhe kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore;

"Garancitë" do të thotë deklaratat dhe garancitë që Shitësi i jep Blerësit dhe, anasjelltas ato që Blerësi i jep Shitësit në Nenin 7.

1.2 Interpretimet

Në këtë MBA (përfshirë përshtimin në pjesën hyrëse dhe Anekset që i bashkangjiten), me përashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe shprehimi i apo në varësi të përmhajtjes:

a) referencat në termin Nenet nënkuption referencat në nenet e kësaj MBA-je, dhe referencat në termin Shtojcat nënkuption shtojcat e kësaj MBA-je;

b) një referencë në çdo Legjislacion, rregullore, akt apo klauzolë ligjore do të interpretohet si një referencë në gjendjen e tyre aktuale, duke pasur parasysh ndyshimet, modifikimet apo zëvendësimet e herë-pas-herësime të tyre;

c) përvet kur parashikohet ndryshe, referencat në një marrëveshje, përfshijnë çdo ndryshim, modifikim, shtojcë apo heqje dorë mbi këtë marrëveshje rast pas rasti;

d) referencat ndaj një personi do të interpretohen në mënyrë të tillë që të përfshijnë çdo individ, firmë, shoqeri, organ qeveritar, apo qdo entitet tjeter të themeluar si një entitet me personalitet të vecantë si dhe do të përfshijë çdo shoqeri pasuese (me anë të bashkimit apo në ndonjë formë tjeter) të kësaj shoqërie;

e) referencat në njësia kohore të ditës do të interpretohen sipas kohëmatësit në Tiranë;

f) referencat në çdo dokumenti në "formën e miratuar" nënkuption dokumentin në formën e nënshkuar apo të sigluar nga apo për llogari të Palëve për qëllim identifikimi;

g) kur përllogaritet një periudhë kohore brenda të cilës apo pas së cilës do të kryhet një veprim apo të ndërmerrët një procedurë, do të përashtohet dita të cilës i referohet për përllogaritjen e kësaj periudhe, dhe nëse dita e fundit e kësaj periudhe nuk është një Ditë Biznesi, periudha kohore do të përfundojë në ditën pasuese që është Ditë Biznesi;

h) numri njëjës përfshin dhe shumësin dhe anasjelltas;

i) titujt e Neneve dhe të Anekseve janë vendosur vetëm për lehti referimi dhe nuk do ndikojnë në ndonjë mënyrë në interpretimin e tyre;

j) qdo dokument që i bashkangjitet kësaj MBA-je, përfshirë Anekset e saj, konsiderohet pjesë integrale e kësaj MBA-je dhe do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishte në mënyrë të shprehur pjesë e përbajtjes së kësaj MBA-je dhe qdo referencë në këtë MBA duhet që të përfshijë Anekset e saj dhe qdo dokument tjetër që i bashkangjitet kësaj MBA-je; dhe

k) referencat ndaj një Pale do të konsiderohet që përfshin dhe personin të cilin, në mënyrën e lejuar, i junë kaluar të drejtat e kesaj Pale.

2. OBJEKTI DHE QELLIMI I TRANSAKSIONIT

2.1 Shitia dhe Blerja e Aksioneve

Sipas kushteve dbe afateve të kësaj MBA-je, METE merr përsipër detyrimin që të shesë dbe të transferojë në pronësi të Investitorit Strategjik, duke dbenë garanci të plotë për titullin, dbe Investitori Strategjik merr përsipër detyrimin që të blejë, të gjitha Aksionet, pa përjashtim, dbe të paguaqë Çmimin e Blerjes në përputhje me Nenin 3.2.

2.2 Transferimi i Pronësisë Ligjore mbi Aksionet

METE do të transferojë tek Investitorit Strategjik pronësinë ligjore mbi Aksionet, të lirë nga çdo barrë, në Datën e Mbylljes dhe në përputhje më kushtet dbe afatet e kësaj Marrëveshje.

3. ÇMIMI I BLERJES

3.1 Çmimi

Çmimi total i blerjes së Aksioneve është njëqind e dy milion Euro (EUR 102,000,000) ("Çmimi i Blerjes").

Çmimi i Blerjes nuk do të përfshijë tarifat për regjistrimin apo ndryshimin e pronësisë mbi Aksionet, të cilat do të janë plotësishët në ngarkim të Investitorit Strategjik.

3.2 Pagesa

Investitorit Strategjik do t'i paguaqë METE-s Çmimin e Blerjes në Euro, në Datën e Mbylljes, duke i dorëzuar METE-s déshminë e transferimit sëft të fondeve, në gjendje menjëherë të aksesueshme, në llogarinë bankare (të dhënët e së cilës mund të ndryshohen nga Shitësi): Banku e Shqiperise, llogaria Nr. 4221010E.

METE do t'i kthejë Garancinë e Ofertës Investitorit Strategjik vetëm pasi Çmimi i Blerjes të jetë depozituar në llogarinë bankare të METE-s.

3.3 Rivlerësimi i Çmimit të Blerjes

Brenda gjashës (6) muajve nga Data e Mbylljes, Blerësi do t'i dërgojë Shitësit një deklaratë ("Deklarata e Mbylljes") të përgatitur në përputhje me IFRS, dhe ku përcaktohet vlerësimi i bërë nga Blerësi i aseteve neto ("Vlera Neto e Aseteve e Propozuar për Mbylljen"). Deklarata e Mbylljes duhet që të jetë e detaujar në masën e arsyeshme.

Shitësi ka afat gjashëtëdhjetë (60) ditë që të shqyrtojë Vlerën Neto të Aseteve të Propozuar për Mbylljen. Në rast se Shitësi nuk bie dakori me Vlerën Neto te Aseteve te Propozuar për Mbylljen, Shitësi do t'i dërgojë Blerësit, jo më vonë sesa Dita e fundit e Biznesit të këtij afati gjatshtëdhjetë-ditore, një njoftim ku përcaktohet në hollësi të arsyeshme, ndryshimet që duhen bërë në Vlerën Neto te Aseteve te Propozuar për Mbylljen.

Në vijim, Blerësi ka afat njëzet (20) ditë nga dita e marrjes së njoftimit të Shitësit që të shqyrtojë dhe të vlerësojë këtë njoftim.

Nëse Shitësi dhe Blerësi nuk arrjnë që të zgjedhin plotësishët mosmarrëveshjet midis tyre brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita që Blerësi merr përgjigjen e Shitësit, çështjet që janë objekt i mosmarrëveshjes do t'i paraqiten PricewaterhouseCoopers, në cilësinë e auditorit të pavarur.

Ky auditor i pavarur kontabël duhet që të përcaktojë korrigimet që duhen bërë në Vlerën Neto te Aseteve te Propozuar për Mbylljen. Auditori i pavarur kontabël ka të drejtë që të bëjë korrigime vetëm për ato çështje të Vlerës Neto te Aseteve te Propozuar për Mbylljen të cilat janë objekt i mosmarrëveshjes dhe këto korrigime duhen bërë në përputhje me IFRS. Auditori i pavarur kontabël do të jep vendimin e tij, mbi çështjet që janë objekt i mosmarrëveshjes në formë të shkruar ku të përfshijë, në masën e arsyeshme, argumentimin e detaujar përmarrjen e këtij vendimi. Palët angazhohen që të ushtrojnë përpjekjet e tyre maksimale në mënyrë që auditori i pavarur kontabël të ketë mundësi që të jep vendimin e tij brenda gjashëtëdhjetë (60) ditëve nga dita kur i janë paraqitur për shqyrtim çështjet që janë objekt mosmarrëveshje. Vendimi i auditorit të pavarur kontabël është përfundimtar dhe me fuqi detyruese për Blerësin dhe Shitësin. Tarifat dhe shpenzimet

e auditorit të pavarur kontabël do të ndahen në mënyrë të pavarur midis Palëve.

"Vlera Përfundimtare Neto e Aseteve për Mbylljen" është vlera përfundimtare neto e aseteve për Mbylljen (e njëjtë me vlerën totale të aseteve të OSSH-së pasi i është zbrinur vlera totale e detyrimeve) që rezulton nga marrëveshja e Palëve apo nga vendimi i auditorit të pavarur kontabël.

Në të dhjetën (10) Ditë Biznesi nga dita kur është përcaktuar Vlera Përfundimtare Neto e Aseteve për Mbylljen, nëse ka vënd për një rivlerësim të çmimit të blerjes, paguesi do t'i paguajë vlerën përkatëse përfituesit, duke e depozituar në llogarine bankare të indikuar për këtë qëllim, me kusht që këto fonde të janë menjëherë të aksueseshme, si më poshtë:

i) nëse Vlera Përfundimtare Neto e Aseteve për Mbylljen është më e lartë sesa Vlera Referuese Neto e Aseteve, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë më shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të diferençës midis Vlerës Përfundimtare Neto të Aseteve për Mbylljen dhe Vlerës Referuese Neto të Aseteve, vlerë e cila do të konvertohet në Euro (EUR) mbi bazën e kursit të këmbimit që zbatohet pesë (5) Ditë Biznesi përpëra ditës së pagimit;

ii) nëse Vlera Përfundimtare Neto e Aseteve për Mbylljen është më e vogël sesa Vlera Referuese Neto e Aseteve, Shitësi do t'i paguajë Blerësit një shumë të barabartë më shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të diferençës midis Vlerës Përfundimtare Neto të Aseteve për Mbylljen dhe Vlerës Referuese Neto të Aseteve, vlerë e cila do të konvertohet në Euros (EUR) mbi bazën e kursit të këmbimit që zbatohet pesë (5) Ditë Biznesi përpëra ditës së pagimit;

iii) pavarësish që sa më sipër, vlera e rivlerësimit të çmimit të blerjes nuk do të tejkalojë pesëdhjetë përqind (50%) të Çmimit të Blerjes;

iv) rivlerësimi i çmimit të blerjes nuk do të bëhet nëse vlera e tij nuk është më e lartë sesa pesë përqind (5%) e Çmimit të Blerjes.

Palët bien dukuri në mënyrë të shprehur që Vlera Neto e Aseteve e Propozuar për Mbylljen dhe Vlera Përfundimtare Neto e Aseteve për Mbylljen do të përcaktohen në përputhje me Udhëzimet për Llogaritjen e VAN-së për Mbylljen e bashkangjitur si Aneksi 13.

3.4 Tarifa e Suksesit e IFC-së

Blerësi do t'i paguajë IFC-së një tarifë suksesi në vlerën një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë dollarë amerikanë (USD 1,360,000). Kjo shumë, nga e cila nuk do të bëhet ndonjë zbritje e çfarëdo lloji qoftë për taksa, detyrime, barrë apo zbritje të tjera (shlyerja e të cilave do të jetë plotësish në ngarkim të Blerësit), do të pagubet brenda pesë (5) Ditë Biznesi nga Data e Mbylljes në llogarinë e IFC-së të përcaktuar më poshtë apo në një bankë tjetër të indikuar nga IFC-ju:

Banka:	Wachovia Bank N.A., New York
Adresa:	11 Penn Plaza, Floor 4, New York, NY 10038
Emri i Llogarisë	IBRD
Numri i Llogarisë:	2000192003476
Swift Code:	PNBPLUS3NNYC
ABA Number:	026005092

4. KUSHTET PARAPRAKE PËR MBYLLJEN

Detyrimi i Blerësit për të blerë Aksionet dhe detyrimi i Shitësit për të shitur Aksionet sipas MBA-së, është i kushtëzuar nga përbushja ose beqja dorë me shkrim, përpëra ose në Datës së Mbylljes, të kushteve të mëposhtme.

Secila Palë do të ushtrojë përpjekjet maksimale për të përbushur Kushtet Paraprake përkatëse brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga Data e Nënshtkrimit.

Kjo MBA do të konsiderohet nul dhe e pavlefshme nëse brenda afatit nëntëdhjetë-ditor (90), të mësipërm, Këshilli Mbikqyrës i Blerësit nuk do të miratojë këtë Marrëveshje dhe Transaksionin, apo nëse Kuvendi Shqiptar nuk e aprovon ose ratifikon atë, apo nëse Këshilli i Ministrave nuk jep miratimin për Investorin Strategjik, apo nëse Autoriteti i Konkurrencës nuk e miraton Transaksionin, apo nëse Kuvendi Shqiptar nuk aprovon një ligj ("Ligji Ratifikues"), me qëllim që:

a) Blerësi apo Shoqëria, sipas rastit, të fitojë titull të plotë ligjor, dhe të lirë e të pastër nga çdo barrë, mbi Aksionet qëdo asci tjetër kryesor të nevojshëm për ushtrimin e Aktivitetit, sipas rastit;

b) Shoqëria të fitojë të drejtë të plota ligjore si përfinuese e servituteve të nevojshme për përdorimin e pronave kryesore të paluajtshme dhe ushtrimin e Aktivitetit;

c) Vendimi I i KM të jetë i vlefshëm dhe i zbatueshëm siç përcaktohet në këtë vendim, dhe asetet dhe detyrimet e përcaktuara në Vendimin II të KM do të transferohen nga dhe përkundrejt entiteteve të përcaktuara në mënyrë specifikë në Vendimin II të KM, dhe Republika e Shqipërisë do të zhëndëmojë Shoqerinë dhe Blerësin, sipas rastit, për çdo dëm, humbje dhe kosto që rezulton nga pavlefshmëria, joefektiviteti, apo mosbatueshmëria e çdo akti apo ngjarje të parashikuar në këtë paragraf;

d) parametrat kryesorë të kuadrit ligjor, siç përcaktohet në Deklaratën Rregullatore, të ruben të pandryshuar deri deri në përfundimin e afateve kohore të përcaktuara në Deklaratën Rregullatore;

e) aktet normative perkatëse mbi falimentimin nuk do të zbatohen ndaj OSSH-së në rast se gjatë periudhës së falimentimit kredidhënësit e KESH-it do të kundërshtonin kontributin që KESH ka bërë në OSSH në formën e kapitalit në natyrë dhe/ose transferimin e aksioneve nga KESH tek METE përparrat datë së ketij dokumenti dhe/ose transferimin e aseteve dhe detyrimet e përcaktuara në paragrafin (c) më sipër;

f) Republika e Shqipërisë do të zhëndëmojë Shoqerinë dhe Blerësin, sipas rastit, për çdo dëm, humbje dhe kosto që rezulton nga çdo shkelje të huamarrësit (Republika e Shqipërisë dhe/ose KESH) të, apo në rast të mospërbushjes (përfshirë këtu pa kufizime përshtpjtimin për ripagimin e kredisë, ndërprerjen e saj, kostot dhe penalitetet përkatëse) sipas, çdo marrëveshje financimi afatgjatë në lidhje me aktivitetin e shpërndarjes që i bashkangjitet Marrëveshjes për Ripagimin Afatgjatë të Borxhit midis KESH-it dhe OSSH-së të parashtruar në Shtojcën Informuese ("Marrëveshja e RAB"), dhe për çdo dëm, humbje apo kosto që vjen si pasojë e shkeljes që KESH i bën Marrëveshjes së RAB-it;

g) legjislacioni përkatës tatimor të parashikojë që borxhi i keq i OSSH-së, sipas përcaktimit të bërë nga Rregulatori në përputhje me Deklaratën Rregullatore, të trajtohet si borxh i keq përfekt të tatimeve.

Për shmanget të çdo dyshimi, detyrimet e Republikës së Shqipërisë për zhëndëmit, të parashikuara për t'u bërë pjesë e Ligjit Ratifikues sipas Nenit 4 (c) dhe (f), konsiderohen të pavarura ndaj, dhe detyrimet shështë mbi, detyrimet për zhëndëmit të parashikuara në Nenin 8 të kësaj Marrëveshje.

4.1 Kushtet Paraprake nën Përgjegjësinë e Shitës

a) Të gjitha Garancitë të janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore, që nga Data e Nënshkrimit dhe në Datën e Mbylljes, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur këto Garanci të janë dhënë në Datën e Nënshkrimit (përveç rastit kur këto Garanci lidhen shprehimisht me një datë të caktuar apo me një periudhë të caktuar kohore, rast në të cilin këto Garanci duhet që të janë të vërteta dhe të sakta në këtë datë apo në lidhje me këtë periudhë);

b) OSSII-ja të ketë marrë nga Rregulatori (i) të gjitha Licencat e kërkua për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhë shitjen me pakicë të energjisë elektrike dhe (ii) të gjitha miratimet për transferimin e aseteve për llogari të OSSH-së;

c) OSSII-ja të ketë marrë letrën e dorëheqjes të individuve të listuar në Aneksin 6, nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OSSH-së dhe nga anëtarët e organeve drejtuese të OSSH-së, me efekt që nga Mbyllja, që komfirmon që OSSII-ja nuk i detyrohet atyre ndonjë shumë përfarëdo arsyë dbe aksionari i vetëm dhe Këshilli Mbikqyrës së OSSH-së, përkatësisht, të ketë miratuar këtë dorëheqje;

d) të janë mbajtur të gjitha mbledhjet nevojslume të organeve kompetente të OSSH-së, përfshirë ato të Këshillit Mbikqyrës, ku të jetë vendosur mbi çështjet e parashtruara në Nenin 5.2 dhe 5.3 dhe të janë përmbyshur kërkësat e regjistrimit siç përcaktohet në Nenin 5.2;

e) Kuvendi Shqiptar të ketë miratuar Deklaratën Rregullatore në formën e miratuar nga Rregulatori me vendimin nr. dyshëdhjetë (12), 3 Mars 2009;

g) Banka Botërore të ketë dhënë garanci për rikun e pjesshëm në formën dhe me përbajtjen që Blerësi e gykon të kënaqshme dhe kjo garanci të jetë miratuar nga Kuvendi Shqiptar;

Rregullatori tē ketē miratuar procedurat e tenderit tē cilave i referohet Neni 4 i Deklaratës Rregulatorë (i) pér përgjedhjen e bankave nē lidhje me çdo detyrim tē ri finanziar që OSSH-ja do tē marrë përsipër, dhe (i) prokurimin e energjisë elektrike pér mbulimin e humbjeve, nē çdo rast nē formën dhe me përbajtjen që Blerësi e gykon tē kënaqshme.

4.2 Kushtet Paraprake nēn Përgjegjësinë e Blerësit

a) Blerësi tē ketë marrë tregullisht tē gjitha Autorizimet e këruara, përfshirë autorizimet nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, nē përputhje me Legjislacionin, dhe çdo autorizim apo aprovim tjetër tē nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar me qëllim ekzekutimin e Transaksionit nē formën e parashikuar këtu; dhe

b) Blerësi tē sugorojë që tē jenë marrë tē gjitha vendimet e organeve kompetente te saj tē nevojshme pér tē ndërmarrë detyrimet e parashikuara nē këtë MBA me qëllim ekzekutimin dhe zhbatimin e Transaksionit.

5. ANGAZHIMET DERI NË MBYLLJE

5.1 Angazhimet Shitësit Para-Mbylljes

Shitësi angazhohet që përpura Datës së Mbylljes:

a) tē ndërmarrë, apo tē bëjë tē mundur që OSSH-ja tē ndërmarrë, sa më shpejt që tē jetë e mundur pas Datës së Nënshkrimit, tē gjitha depozitimt dhe aplikimet e nevojshme apo tē këruara si detyrim i Shitësit, përkatësisht, me qëllim që Blerësi tē realizojë blerjen e Aksioneve nē Datën e Mbylljes, nē përputhje me MBA-në, dhe tē bëjë tē mundur që OSSH-ja t'i japë Blerësit tē gjithë asistencën e nevojshme pér tē marrë autorizimet dhe Liçencat që Blerësi kérkon nē mënyrë tē arsyeshme sipas MBA-së;

b) t'i mundësojë Blerësit, pasi ky tē këtë njoftuar Shitësin nē mënyrë tē arsyeshme, akses nē aktivitetin e OSSH-së, nē masën e arsyeshme, dhe ky akses përfishin tē drejtëni pér tē pasur askes tek menaxherët dhe nē ambjentet e OSSH-së si dhe tē shqyrtojë dhe, sipas rustit, tē negociojë kushtet e punësimit me menaxherët dhe tē hyjë me to nē marrëveshje me efekt pas Mbylljes, dhe tē kryejë inspektime tē ambjanteve nē përputhje me Legjislacionin, sidoqoftë me kusht që Blerësi, nē ushtrimin e tē drejtave tē tij sipas këtij paragrafi, tē mos ndërhyjë nē aktivitetin e përditshëm tē OSSH-së;

c) t'i vërë Blerësit nē dispozicion, çdo muaj, tē gjitha llogaritë e menaxhimit pér OSSH-në jo më vonë së tē pesëmbdhjetë (15) Dite Biznesit nga ditë e fundit e muajit përkatës, nëse kjo është e mundshme dhe praktike; dhe

d) tē mos kryejë veprime me Aksionet apo tē vërë ndonjë barrë mbi to.

5.2 Aksionari i Vetëm

Shitësi angazhohet që përpura apo nē momentin e Mbylljes tē bëjë tē mundur që aksionari i vetëm i OSSH-së tē miratojë transferimin e Aksioneve nga Shitësi tek Blerësi si dhe tē gjitha kushtet dhe afatet e këtij transferimi. Shitësi angazhohet që tē bëjë tē mundur që OSSH-ja tē regjistrojë sa më shpejt që tē jetë e mundur vendimin e aksionarit tē saj tē vetëm nē Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5.3 Administrimi i OSSH-së midis Datës së Nënshkrimit dhe Darës së Mbylljes

5.3.1 Gjatë Periudhës së Para-Mbylljes, Shitësi nuk duhet që tē mundësojë apo tē lejojë OSSH-në që tē kryejë veprimet e mëposhtme, përvçese kur Blerësi jep miratimin e tij:

a) tē ndryshojë aktet organizative tē OSSH-së apo statutin e saj, përvçese nē rastet kur parashikohet shprehimisht nē MBA;

b) tē emetojë apo shesë aksione tē kapitalit aksionar tē autorizuar apo tē emetuar tē OSSH-së apo tituj tē saj, tē cfarëdo natyre, tē blejë, nē mënyrë tē drejtpërdrejtë apo jo tē drejtpërdrejtë, përmes riblerjes së aksioneve tē veta apo ndonjë mënyrë tjetër, aksione tē kapitalit aksionar tē autorizuar ose tē emetuar apo tituj tē tjerë, tē emetojë tituj tē borxhit, apo tē japë ose tē hyjë si palë nē kontrata opzioni, gurancie, nënshkrimi, detyrimi pér tē blerë apo forme tjetër angazhimi tē çdo lloji nē lidhje me to, apo tē emetojë dëshmi pér pjesmarrje nē fitime, ose tē miratojë, qoftë me shkrim apo nē ndonjë formë tjetër, që tē kryejë një nga veprimet e sipërpërmenduara.

c) tē fitojē tē drejta pronësie apo tituj tē tjerō mbi kapitalin e çdo shqërie apo entitet tjetër apo tē bëjë pjesmarrje në kapital apo tē drejta pronësie (më përjashtim kur kjo mundësobet përmes ekzekutimit tē një barre siguruese me kolateral si pasojë e mospérmbushjes së detyrimit përkatës) në çdo aktivitet dhe tē mos hyjë në ndonjë bashkim apo konsolidim me ndonjë entitet tjetër;

d) tē deklarojë apo tē paguajë dëvidentë apo forma tē tjera shpërndarjeje apo pagimi në lidhje me aksionet apo pjesmarrje tē tjera në kapital apo tē bëjë shpërndarje ose kthime tē tjera ndaj aksionerëve të OSSH-së.

e) tē shesë, transferojë, ngarkojë me peng, jepë me qera apo tē disponojë ose ngarkojë me barrë në ndonjë formë tjetër asetet e saj kryesore, pasuritë, apo ndonjë pjesë kryesore tē pajisjeve tē përdorura në shërbim tē aktivitetit tē saj;

f) tē lidhë, zgjasë afatin, ndryshojë apo shfojë çdo marrëveshje qiraje mbi pasuri tē paluajtshme tē OSSH-së (qoftë si qiradhënës apo qiramarrës) jashtë veprintarisë së saj së zakonshme;

g) tē miratojë ndryshime thelbosrë në kushtet dhe afatet e punësimit tē punonjësve të OSSH-së, apo tē ndryshojë në mënyrë thelbosore numrin e punonjësve;

h) tē hyjë në ndonjë marrëveshje tē re financimi apo forme tjetër angazhimi për tē dhënë financim, garanci apo lloje tē tjera tē ngjashme financimi ose produktesh, apo tē mundësojë ri-investimin apo ripërtëritjen e çdo financimi ekzistues në një vlerë që e tejkalon shifrën prej pesë milion Euro (€ 5,000,000);

i) tē bëjë shpenzime kapitali në një vlerë që e tejkalon shifrën prej një milion Euro (€ 1,000,000); megjithatë Blerësit nuk duhet që tē refuzojë në mënyrë tē paarsyeshme që tē jepë pëlqimin e tij paraprak për shpenzimet që e tejkalojnë këtë shifër;

j) tē hyjë në ndonjë transaksion, marrëveshje apo tender tē hapur, apo tē ndryshojë ose ndërpresë ndonjë transaksion ose marrëveshje vlera e të cilëve e tejkalon shifrën prej njëqind mijë Euro (€ 100,000);

k) tē punësojë personel apo tē rrësë përqindjen aktuale apo tē ardhëshme tē kompensimit, me përjashtim tē rritjeve tē hërra në përputhje me praktikat e mëparshme në kuadër tē planeve ekzistuese përfshirë ato për kompensim, apo tē bëjë ndryshime thelbosore në organizatat e punonjësve të OSSH-së;

l) tē ndryshojë kushtet apo afatet e punësimit tē drejtorëve apo punonjësve kryesorë të OSSH-së apo t'u bëjë këtyre personave pagesa në formë bonusesh apo forma tē tjera, me përjashtim kur këto pagesa bëhen në përputhje me marrëveshjet aktuale individuale apo kolektive;

m) tē fitojë apo disponojë, në çfarëdo formë, një interes në kapitalin e një shqërie tjetër apo tē fitojë, disponojë apo jepë me qira (si qiradhënës apo qiramarrës) çdo aktivitet tregtar apo pjesë aktiviteti tregtar;

n) tē paguajë, shlyejë apo përbushë në lidhje me një pretendim, përgjegjësi apo detyrim jashtë kuadrit tē ushtrimit të aktivitetit tē tyre tē zakonshëm;

o) tē ndryshojë në mënyrë thelbosore dhe me pasojë përkeqësuese shërbimet standarde ndaj klientëve;

p) tē zvogëlojë mbulimit me siguracion apo tē shkelë afatet e pagimit tē primeve tē sigurimit;

q) tē ndërpresë ushtrimin normal tē Aktivitetit apo tē ndërpresë ose ndalojë zhvillimin e gjithë apo tē një pjesë thelbosorë tē aktivitetit tē OSSH-së;

r) tē aplikojë për ndryshim në tarifa;

s) tē angazhohet në veprimitari që sjell si pasojë, apo që ka shumë probabilitet që tē sjellë si pasojë, një Ndryshim Thelbosor Përkeqësues.

5.3.2 Në përjashtim tē paragrafit pararendës, Shitësi nuk kërkohet që tē marrë miratimin paraprak tē Blerësit gjatë periudhës para-mbylljes, për tē kryer veprimet e mëposhtme:

a) blerjen e energjisë elektrike në kuadër tē ushtrimit tē zakonshëm të aktivitetit tē shpërndarjes; dbe

b) riparimet në rrjetin e shpërndarjes në kuadër tē ushtrimit tē zakonshëm të aktivitetit.

5.3.3 Gjatë Periudhës Para-Mbylljes, Shitësi duhet tē sigurojë që OSSH-ja tē ushtrojë aktivitetin e saj me përgjegjësinë e duhur dbe vetëm në masën e ushtrimit tē zakonshëm tē

aktivitetin, dhe tē mos lejojë që OSSH-ja tē aplikojë ndonjë metodë tē re administrimi, mbajte tē llogarive apo ushtrimi aktiviteti.

5.3.4 Gjatë Periudhës Para-Mbylljes, Shitësi duhet tē bëjë tē mundur që Blerësi tē veprojë përmes maksimumi dy përfaqësuesve tē autorizuar ("Vëzhguesit"). Në varësi tē nënshkrimit tē marrëveshjes së konfidencialitetit, sipas kushteve dhe afateve tē kënaqëshme për Shitësin, dhe në përputhje me dispozitat përkatesisht tē zbatueshme të MBA-së, Vëzhguesit:

a) duhet që tē kenë akses në armbjentet e OSSH-së;

b) kanë tē drejtë që tē ftohendhë tē marrin pjesë (në cilësinë e vëzhguesit pa tē drejtë vote) në tē gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës dhe komitetit tē auditimit të OSSH-së, si dhe tē pajisen me dokumentacionin e shpërndurë përkatesisht;

c) kanë tē drejtë t'u vihat në dispozicion, pa vonesh, gjithë informacioni dhe kopjet e dokumentacionit tē kërkuar prej tyre, sipas rastit, në mënyrë tē arsyeshme;

me kusht që ushtrimi i tē drejtës së Blerësit sipas këtij paragrafi tē mos ndërhyjë në ushtrimin e aktivitetit tē përditshëm të OSSH-së.

5.3.5 Shitësi duhet që tē sigurojë që OSSH-ju tē ruajë statusin e saj ekzistues dhe tē kryejë tē gjitha përpjekjet e arsyeshme tregtare që tē ruajë organizimin e saj tregtar tē pacënuar.

5.3.6 Shitësi duhet tē njoftojë Blerësin menjëherë me shkrim nëse është në dijeni pér (i) një Ndryshim Thelbësor Përkeqësues dhe/o se (ii) çdo rrëthanë që krijohet gjatë Periudhës Para-Mbylljes dhe që do tē, apo mund tē, shkaktojë shkeljen e një prej angazhimeve tē përmenduara më sipër.

5.4 Angazhimet e Shitësit në lidhje me pasuritë e paluajtshme

Shitësi duhet tē ushtrojë përpjekjet e veta maksimale me qëllim që tē sigurojë regjistrimin e menjëherëshëm në emër të OSSH-së, përpara dhe pas Datës së Mbylljes, tē çdo pasurie tē nevojshme pér ushtrimin e aktivitetit tē shpërndarjes dhe tē furnizimit me pakicë tē energjisë, nëse OSSH-ju nuk figuron i regjistruar si pronari i ligjshëm i tyre në Datën e Nënshkrimit. Nëse përparu Datës së Mbylljes, OSSH-ja nuk figuron i regjistruar si pronuri i ligjshëm i këtyre pasurive (apo tē çdo pasurie tjetër tē deklaruar në pronësi të OSSH-së sipas Aneksit 3), Shitësi duhet që tē asistojë Blerësin me qëllim që tē mundësojë këtë regjistrim pas Datës së Mbylljes.

5.5 Angazhimet e Blerësit

Nëse Blerësi është një shoqëri e krijuar vetëm pér qëllim tē këtij Transaksi, atëherë Blerësi duhet tē sigurojë që nuk do tē ketë Ndryshim Kontrolli në strukturën e tij pa miratimin paraprak me shkrim tē Shitësit, në gjykimin e plotë tē Shitësit, gjatë pesë (5) viteve nga Data e Mbylljes.

Parografi pararendës nuk applikohet nëse Blerësi nuk është një shoqëri e krijuar pér qëllim tē caktuar.

5.6 Angazhimet e Përhashkëta

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, Palët bien dakort që tē bashkëpunojnë dhe tē bëjnë përpjekjet maksimale që tē realizojnë, apo tē mundësojnë realizimin e, tē gjitha vepprimeve dhe tē kryejnë, apo tē mundësojnë kërjen e, tē gjitha gjëratë tē nevojshme, tē domosdoshme apo tē këshillueshme, sipas legjislacionit tē zbatueshëm, me qëllim që Transaksi tē jetë i vlefshëm dhe tē realizohet në përputhje me MBA-në

5.6.2 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, secili, Blerësi dhe Shitësi do tē bëjnë përpjekjet e tyre maksimale që tē marrin tē gjitha Autorizimet e nevojshme apo tē tē këshillueshme me qëllim që Transaksi tē jetë i vlefshëm dhe tē realizohet sipas MBA-në, duke e theksuar që secila Pale do tē konsultohet me Palen tjetër përpara se tē ndërmarrë ndonjë veprim pér martjen e miratimeve apo lejeve që leshohen nga një agjenci apo nëpunës i autoriteteve publike shqiptare.

5.6.3 Republika e Shqipërisë do tē bëjë përpjekjet e saj maksimale që tē përfshijë ne legjislacionin e saj mëkanizmin pér zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë, i cili tē reflektojë praktikat më tē mira ndërkombëtare.

6. MBYLLJA

6.1 Vendi dhe Data e Mbylljes

Mbyllja do tē realizohet në Tiranë, Shqipëri, menjëherë sapo tē gjithë kushtet paraprake tē përcaktuara në Nenin 4 tē janë përbushur, me përjashtim tē atyre nga tē cilat është hequr dorë, 2656

("Data e Mbylljes").

Nëse për ndonjë arsy e shprehur, Mhyllja nuk realizohet në datën e Mbylljes, Palët do të takohen përsëri në të pestën (5) Ditë të Biznesi, që pason, dhe të përpinqen edhe njëherë që të realizojnë Mbylljen. Nëse përsëri Mhyllja nuk realizohet, MBA-ja do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur pa paragjykime për detyrimet, të drejtat dhe mjetet për rekuperim të Palëve në lidhje me këtë zgjidhje, përvësje nëse Palët bien dakort ndryshe në një dokument ku përeaktohen masat për Mbylljen e Transaksionit në një moment të mëvonshëm.

6.2 Dorëzimi i Dokumentave në Mbyllje

- Dorëzimi i një kopjeje të njësuar të minutave të takimit të aksionarit të vetëm të OSSH-së;
- dorëzimi i një kopjeje të njësuar të minutave të takimit të Këshillit Mbikqyrës të OSSH-së (i) ku evidentohet dorëheqja e Drejtorit të Përgjithshëm të OSSH-së dhe emërimi i personit që do e zëvendësojë, dhe (ii) ku emërohet Kryetari i ri i Këshillit Mbikqyrës;
- evidencë, në formën që Shitësi e konsideron të kënaqshme, për pagimin e Çmimit të Blerjes në përputhje me Nenin 3.2;
- kopje të letrave të dorëhenjës të referuara në Nenin 4.1 (c) më sipër;
- dorëzimi nga Shitësi tek Blerësi i (i) certifikatave për kalimin e pronësisë mbi Aksionet, të ekzekutuara rregullisht, dhe (ii) një kopje të regjistrat të aksionarëve të OSSH-së ku të jetë regjistruar transferimi i Aksioneve në pronësi të Blerësit;
- dorëzimi nga Shitësi tek Blerësi i (i) evidencës që Kuvendi Shqiptar ka miratuar Transaksionin dhe MBA-në, dhe (ii) evidencës që Këshilli i Ministrave ka miratuar Investitorin Strategik;
- dorëzimi i evidencës së miratimit të Transaksionit nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës;
- b) dorëzimi i evidencës së miratimit nga ana e ERE-s për transferimin e aseleve tek OSSH-ja dhe ndryshimin e pronësisë së OSSH-së;
- i) dorëzimi i evidencës mbi Ligjin e Ratifikues;
- j) dorëzimi i evidencës për garancinë e dhënë mbi riskun e pjesshëm sipas Nenit 4.1; and
- k) dorëzimi i provave për zmadhimin e kapitalit te OSSH (certifikatë nga Qendra Kombtare e Regjistrimit) ne reflektim te ngjarjeve te parashikuara ne Vendimit II te KM..

6.3 Pasojat e Mbylljes

Që nga Data e Mbylljes, Blerësi do të jetë pronar me të drejta të plota i Aksioneve dhe në vijim do të përlitojë në shpërndarjen e dividendi, përfitimeve, rezervave, apo aseteve dhe në përgjithësi, në çdo dhe të gjitha shpërndarjet që do të realizohen nga OSSH-ja që nga Data e Nënshkrimit. Që nga ky moment, Blerësi mund te ushtrojë të gjitha të drejtat që lidhen Aksionet.

Që nga Data e Mbylljes, për sa kohë që Shitësi zotëron më shumë se pesëmbëdhjetë përqind (15%) të aksioneve në OSSH dhe për sa kohë që ka një Këshill Mbikqyrës në OSSH, Shitësi ka të drejtë që të emërojë një përfaqësues në këtë këshill.

6.4 Kufizimet në shitjen e Aksioneve në të ardhmen

Deri në përvjetorin e tretë (3-të) të Datës së Mbylljes, Blerësi nuk ka të drejti që, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të shesë apo transferojë Aksionet tek një palë e tretë pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit, me kusht që ky miratim të mos refuzohet nëse (x) shitja apo transferimi i bëhet një Personi të Lidhur me Blerësin apo (y) shitja apo transferimi i bëhet një institucioni financiar ndërkombëtar, i cili përfiton të drejta minoritare në OSSH.

Në rastin kur Aksionet i shiten apo transferohen një Personi të Lidhur me Blerësin, ky Person i Lidhur, deri në përvjetorin e tretë (3-të) të Datës së Mbylljes, nuk ka të drejtë që, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, të shesë apo transferojë Aksionet tek një palë e tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit.

Transferimi i aksioneve, i bërë pa miratimin e Shitësit, në kundërshtim me kushtet e këtij Neni 6.4, do të konsiderohet nul dhe i pavlefshëm.

7. DEKLARATAT DHE GARANCITË

7.1 Deklaratat dhe Garancitë e Blerësit

Blerësi dhe përfaqësuesi(i) i tij kanë (i) kompetencat dhe autoritetin e kërkuar për të lidhur dhe vepruar sipas MBA-së dhe çdo dokumenti tjeter që duhet të ekzekutohet në lidhje me të; (ii) marrë dhe qarkulluar të gjitha autorizimet dhe njoftimet që kërkohen me ligj për ekzekutimin e

MBA-së; (iii) MBA-ja dhe të gjithë dokumentat e tjerë që duhet të ekzekutohen në lidhje me të dhe në të cilat Blerësi është palë, krijojnë aktualisht apo në të ardhmen, në momentin që ekzekutohen, detyrime të vlefshme të Blerësit, sipas kushteve përkatëse.

7.1.1 Falimentimi dhe procedurat përkatëse

Blerësi nuk ka qënë dhe aktualisht nuk është subjekt i një procesi në kuadër të parandalimit dhe trajtimit të vështirësive të një shoqërie tregtare (ose të një procedure të ngjashme) apo subjekt i një vendimi ose procesi për prishjen apo likuidimin e tij si dhe nuk ekziston asnjë arsyë për të cilën Blerësi mund të bëhet subjekt i një procedure apo vendimi të tillë. Blerësi nuk i është nënshtruar një periudhe dyshimi sipas dispozitive ligjore për procedurat kolektive dhe rekuperimi në rrugë gjyqosore.

7.2 Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit në Datën e Nënshkrimit dhe atë të Mbylljes

7.2.1 Mbarëvajtja

OSSH-ja është një shoqëri aksionare e themeluar sipas Legjislacionint në Republikën e Shqipërisë. Ajo është e organizuar rregullisht, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe konsiderohet në mbarëvajtje sipas Legjislacionint në Republikën e Shqipërisë. Kopjet e dokumentave organizativë të OSSH-së bashkangjiten nën Aneksin 8.

7.2.2 Aksionet të lira nga çdo barrë

Ne Datën e Nënshkrimit, aksionet e emeturara të OSSH-së konsistojnë në 22,665,020 aksione me të drejtë të barabarta dhe me vlerë nominale një mijë LEK (LEK 1,000), vlera totale e të cilave është LEK 22,665,020,000. Aksionet janë emetuar rregullisht, janë paguar plotësisht si dhe janë të lira dhe të çlruara nga çdo Barrë. Të dhëna të hollësishme për çdo rritje në kapitalin e OSSH-së, që nga momenti i themelimit të tij, bashkangjiten në Aneksin 10, i cili sic do te perditesohet ne Datën e Mbylljes pasqyron zmadhimet e kapitalit pas datës se Nënshkrimit (një Aneks 10 i perditesuar do ti dorezohet Blerësit perpara ose ne Daten e Mbylljes). Këto rrije të kapitalit janë realizuar në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Transferimi i Aksioneve nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi sipas dokumentave statutorë të OSSII-së apo ndonjë marrëveshje me palë të treta, ose ligji, rregulloreje, vendimi perfundimtar, urdhëri apo vendimi të ndërmjetëm gjyqësor, dhe kjo Marrëveshje përhën për Shitësin detyrime ligjore të vlefshme dhe të zbatueshme.

7.2.3 Pronar i Ligjshëm

METE është rregullisht i autorizuar që të veprojë si përsaqësues i Republikës së Shqipërisë, që mund të hyjë në këtë Marreveshje dhe që është pronari i ligjshëm i Aksioneve, të cilat përfaqësojnë shtatëdhjetë e gjashtë përqind (76%) të kapitalit aksionar me të drejtë vote dhe të emetuar të OSSH-së. Vetë METE ka të drejtën për të kërkuar emetimin e aksioneve të OSSH-së. Përvec aksioneve te përcaktuara në nenin 7.2.2, nuk ka aksione të tjera, interesa pjesmarrjeje, ortakëri të heshtur, interesa ekonomike apo të një natyre tjeter në OSSH apo mbi aktivitetin e saj, ose angazhime shpërblimi apo marrëveshje për pjesmarrje në fitime në lidhje me OSSH-në, si dhe nuk ka kontrata opzioni, të drejta apo marrëveshje e të ngjashme në lidhje me sa më sipër. METE nuk ka miratuar ndonjë dividend apo fitime të tjera mbi Aksionet dhe që vazhdojnë të janë të pashpërndara.

7.2.4 Aspektet financiare

Llogaritë e Fundit pasqyrojnë me vërtetësi dhe drejtësi gjëndjen e OSSH-së dhe të aseteve dhe detyrimeve të saj në datën 31 Dhjetor 2007.

Llogaritë e Menaxhimit të OSSII-së për të gjitha periudhat pas datës 31 Dhjetor 2007 janë përgatitur në të gjitha aspektet në mënyrën e duhur sipas GAAP vendore dhe nuk lënë vënd për keqinterpretimë nën çfarëdo aspekti thelbësor. METE i ka dorëzuar Blerësit me anë të një letre të datës 10 Mars 2009, një kopje të vërtetë, të saktë dhe të plotë të Llogarive të Menaxhimit.

Që nga 31 Dhjetor 2007, nuk ka pasur ndonjë ndryshim apo nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që, të marra individualisht apo sëbashku, të ketë pasur apo, që me arsyë mendohet të ketë, efekte thelbësishët përkeqësuese mbi aktivitetin e OSSH-së, kushtet (fiskale apo të tjera), rezultatet e aktivitetit, asetet dhe detyrimet, me përshtatim të atyre ngjarjeve të pasqyruara në Llogaritë e Menaxhimit dhe/ose të cilat janë minimizuar me anë te Vendimit II të KM. Që nga 31 Dhjetor 2007, OSSH-ja ka ushtruar aktivitetin e saj në kuadrin e aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë.

7.2.5 Asetet dhe Detyrimet e OSSH-së

OSSH-ja është pronarja e vjetme dhe ekskluzive e aseteve të listuara në Aneksin 3 të cilat janë të lira dhe të çluara nga çdo Barrë, pretendim apo të drejtë të tjera në favor të palëve të treta, përvec përjashtimeve të përmedura në Aneksin 3. OSSH-ja ka në pronësi të gjitha asetet e kërkuarë për ushtrimin e Aktivitetit të suj në Shqipëri. Në Shtojcën Informuese janë listuar të gjitha pasuritë e paluajtshme që OSSH-ja ka në pronësi apo i ka marrë me qira dhe të gjitha servitimet apo të drejtat e tjera në favor të OSSH-së. Palët e treta nuk kanë servitute apo të drejtë të tjera mbi këto pasuri të paluajtshme, me përjashtim të atyre të përshkruara në Shtojcën e Informacionit.

Në vijim, Aneksi 3 paraqet një listë të detajuar dhe të plotë të të gjitha detyrimeve të OSSH-së të cilat nuk janë pasqyruar në Llogaritë e Menaxhimit. Detyrimet e përcaktuara në Vendimin II të KM nuk i përkasin OSSH-së.

OSSH-ja nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje financimi apo të ketë marrë përsipër detyrime financiare, qoftë si huadhëns apo huamarrës, me përjashtim të rasteve të deklaruara në Shtojcën Informuese. Me përjashtim të rasteve të deklaruara në Shtojcën Informuese apo Llogaritë e Menaxhimit, nuk ka detyrime të ndonjë lloji, qoftë të karakterit absolut, të prapambetur, të mundshëm apo të ndonjë karakteri tjetër, qoftë të pagueshmë aktualisht apo në të ardhmen. OSSH-ja nuk ka lëshuar ndonjë garanci, premtim-pagesë, kambial, kontratë garancie, dorzani, deklaratë mbështetëse, letër kredie, letër komforti, apo instrumentë të tjerë të ngashëm në favor të ndonjë pale, me përjashtim të rasteve të deklaruara në Shtojcën Informuese. Të gjitha detyrimet për pagesa të OSSH-së janë paguar rregullisht, plotësisht dhe në kohë, me përjashtim të rasteve të deklaruara në Shtojcën Informuese. Në Shtojcën Informuese janë dekluaratë gjitha shlyerjet e bëra në apo përparrë Darës së Mylljes në lidhje me marreveshjet e financimit ku OSSH-ju është palë dhe ato të parashtruara në Marrëveshjen pëR Ripagimin e Borxhit Afatgjatë midis KESH-it dhe OSSH-së.

Shtoja Informuese përrmban Marrëveshjet pëR Mbledhjen e Llogarive të Arkëveshme midis KESH-it dhe OSSH-së dbe marreveshjes pëR blerjen e energjisë midis KESH-it dhe OSSH-së.

7.2.6 Licencat

Licencat janë plotësisht të vlefshme dhe efektive që nga data e nënshkrimit të tyre. Licencat janë lëshuar në përputhje me Legjislacionin e zbatueshëm dhë janë plotësisht të vlefshme dhe të zbatueshme. Sipas dijenisë së Shitësit, nuk ka asnjë rrethanë apo ngjarje që mund të ndikojë vlefshmrërin e Licencave apo të shkaktojë heqjen e tyre.

7.2.7 Punonjësit e OSSH-së

Një listë e plotë e punonjësve të OSSH-së në Qershor 2008 bashkangjiter këtu si Aneks 4. Që nga kjo date, politikat e OSSH-së në lidhje me menaxhimin e burimeve tjérëzore janë aplikuar në mënyrë konstante dhe koherente. OSSH-ja ka respektuar afatet e pagimit të çdo shume që i detyrohet punonjësve të saj.

7.2.8 Financimet Ndërkombe

KESH-i dhe OSSH-ja kanë nënshkuar Marrëveshjen pëR Ripagimin e Borxhit Afatgjatë, e cila është dekluaruar në Shtojcën e Informacion, sipas së cilës OSSH-ja njeh dbe pranon që disa nga asetet e shpërndarjes që aktualisht janë në pronësi të saj, janë ndërtuar apo blerë me të ardhura nga disa financime të bëra nga organizata ndërkombe ndaj të cilave KESH-i ka detyrime, direkte apo indirekte, ripagimi. OSSH-ja i ka njoftuar këto finansues mbi shkëputjen e aktivitetit të shpërndarjes si dhe transaksionet që parashikohen këtu.

7.2.9 Tatimet

Sipas dijenisë së Shitësit, OSSH-ja ka depozitar, në përputhje me normat përkatëse, të gjitha deklaratat e kërkuarë nga Legjislacioni Tatimor, doganor dhe ai pëR sigurimet shoqërore, depozitimi i të cilave duhej bërë përparrë datës së kësaj marrëveshjeje dhe përmhajja e tyre është e saktë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

OSSH-ja ka paguar rregullisht dhe brenda afateve përkatëse të gjitha Tatimet që duhen vlerësuar apo paguar.

OSSH-ja ka bërë të gjitha zbritjet dhe ndalesat në burim nga të gjitha pagesat kryesore të bëra prej saj, në mënyrën dbe shumat e duhura pëR efekt apo pëR llogari të çdo Tatimi. OSSH-ja i ka raportuar Autoritetit Tatimor të gjitha shumat e zbritura apo të mbajtura në burim në përputhje me ligjin.

7.2.10 Çështjet Gjyqsore

Në Aneksin 9 është bashkangjitur lista e padive të ngritura nga OSSH-ja apo kundër saj. Shitësi nuk është në dijeni të ndonjë pretendimi tjetër thelbësor që është në proces apo që rrezikon të ngrihet ndaj OSSH-së. Sipas njohurisë maksimale të Shitësit, Transaksioni nuk rrezikohet nga ndonjë proces thelbësor gjyqor, arbitrazhi apo administrativ apo hetim. Për qëllime të këtij paragrafi, "thelbësore" do të thotë çdo proces vlera e të cilit e tejkalon shifrën njëqind e pesëdhjetë mijë Euro (EUR 150,000).

7.2.11 Kërkesat Mjedisore

OSSH-ja ka përbushur të gjitha detyrimet mjedisore, siç është pëershruar në Raportin Mjedisor të bashkangjitur në Aneksin 5. Për aq sa Shitësi është në dijeni, nuk ekzistojnë pretendime, procedime, vendime apo hetime në proces apo që mund të ngrihen kundër OSSH-së në lidhje me mos-respektimin e legjislacionit mjedisor, apo ndonjë përgjegjësi (qoftë aktuale apo të ardhme) ose detyrim në lidhje me të.

7.2.12 Falimentimi dbe procedurat përkatëse

OSSH-ja nuk ka qënë objekt i ndonjë procesi në kuadër të parandalimit dhe trajtimit të vështirësive të një shoqërie tregtare (ose të një procedurë të ngashme) apo subjekti i një vendimi ose procesi për shpërndarjen apo prishjen e saj si dhe nuk ekziston asnjë arsyë për të cilën OSSH-ja mund të bëhet subjekt i një procesi apo vendimi të tillë. Gjithashu, OSSH-ja nuk i është nënshtruar një periudhe dyshimi sipas dispozitave ligjore për procedurat kolektive dhe rekuperimin në rrugë gjyqore.

7.2.13 Respektimi i Ligjit

OSSH-ja, që nga themelimi i saj, ushtron aktivitetin në përputhje thelbësore me legjislacionin dbe rregulloret e zbatueshme.

7.2.14 Deklaratat Financiare

Të gjitha deklaratat financiare të OSSH-së që nga themelimi i saj, përfshirë pa kufizim Llogaritë e Menaxhimit, përfaqësojnë në të gjitha aspektet thelbësore të tyre pozitën financiare dhe rezultatet e aktivitetit të OSSH-së në datën dhe periudhën e përcaktuar në to, si dhe janë përgatitur në përputhje me Standartet Shqiptare të Kontabilitetit, përvës Llogarive të Fundit, të cilat janë përgatitur në përputhje me IFRS-në.

7.2.15 Dhënia e Informacionit

Shitësi ka vënë në dispozicion të Blerësit të gjithë informacionin thelbësor në lidhje me asetat dhe detyrimet e OSSH-së. Ky informacion është i vërtetë, i saktë dhe i plotë. Shitësi nuk është në dijeni të ndonjë fakti që ka shkaktaur apo mund të shkaktojë ndonjë Ndryshim Thelbësor Përkeqësues ndaj OSSH-së apo realizimin e transaksionit të parashikuar këtu.

8. PRETENDIMET PËR DËMET

8.1 Përgjegjësia e Shitësit

Që nga Mbyllja dhe në vijim, në varësi të, dhe në përputhje me dispozitat e MBA-së dhe më konkretisht të këtij Neni 8, Shitësi do të dëmshpërblyej (a) Blerësin për çdo Dëm të pësuar prej tij si pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljeve të Garancive të dhëna nga Shitësi sipas Nenit 7; (b) OSSH-në për çdo dëm të pësuar prej saj si pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljeve të Garancive të dhëna nga Shitësi sipas Nenit 7.2.; dhe (c) Blerësin për shkaktimin e një Ndryshim Thelbësor Përkeqësues.

8.2 Përgjegjësia e Blerësit

Që nga Mbyllja dhe në vijim, në varësi të, dhe në përputhje me dispozitat e MBA-së dhe më konkretisht të këtij Neni 8, Blerësi do të dëmshpërblyej Shitësin për çdo Dëm të pësuar prej tij si pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljeve të dhëna nga Blerësi në këtë MBA.

8.3 Përashtimet dbe Kufizimet e Përgjegjësisë së Shitësit

Pavarësisht nga çdo parashikim tjetër sipas kësaj MBA-je, Shitësi nuk do të mbahet përgjegjës sipas kësaj MBA-je:

8.3.1 Kufizimet në Afat

në lidhje me ndonjë pretendim përvëçse (a) në rastin kur një pretendim ngrihet si pasojë e shkeljes së Garancive të përcaktuara në Nenin 7.2.9 (Tatimet), Blerësi i ka dhënë Shitësit një Njoftim Pretendimi brenda afatit ligjor parashkrues që aplikohet në lidhje me detyrimin përkates tatimor në juridikcionin përkates apo brenda trë (3) muajve pasi të jetë parashkuar afat; dhe çdo

pretendim i tillë duhet që (nëse nuk është përmashbur, zgjidhur me pajtim, apo tërhequr më përparrë) të konsiderohet sikur është tërhequr gjashtë (6) muaj pas afatit të përcaktuari më sipër (ose, në rastin e një përgjegjësie të mundshme, gjashtë (6) muaj pasi kjo përgjegjësi të jetë bëre aktuale) më përjashtim kur në lidhje me të kanë filluar procedurat ligjore apo administrative të dyja të njoftuara dhe tajëruara përkatesisht; (b) në rastin kur një pretendim ngrihet si pasojë e shkeljes së çdo Garancie tjetër të Shitësit, Blerësi i jep Shitësit një Njoftim Pretendimi në ose përparrë tre (3) viteve nga Data e Mbylljes.

8.3.2 Pretendimet Minimale

në lidhje me pretendimet që ngrihen si pasojë e shkeljes së një apo disa Garancive përvog nëse (i) ky pretendim tejkalon në bazu individuale (që do të thotë një pretendim që lidhet me të njëjtën apo substancialisht me të njëjtën kategori faktesh) shifrën njëqind mijë Euro (€ 100,000), dhe (ii) ky pretendim kur i bashkohet pretendimeve të tjera që ngrihen si pasojë e shkeljes së Garancive e tejkalon shifrën pesëqind mijë Euro (€ 500,000), në të cilin rast Blerësi ka të drejtë të pretendojë të gjithë shumën e këtij pretendimi, dhe jo vetëm shumën që tejkalon shifrën prej pesëqind mijë Euro (€ 500,000).

8.3.3 Pretendimet Maksimale

i) në lidhje me çdo pretendim që ngrihet si pasojë e shkeljes së Garancive të përcaktuara në Nenin 7.2.1 (Mbarëvajtja), Nenin 7.2.2 (Aksionet të lira nga çdo Barrë), Nenin 7.2.3 (Pronar i Ligjshëm), për të paguar çdo shumë (kur i shtohet çdo shume të pagueshme sipas Nënëtit 3.3 (Rivlerësimi i Çmimit të Blerjes)) e cila do të tejkalone të total njëqind përqind (100%) të Çmimit të Blerjes; (ii) në lidhje me çdo pretendim që ngrihet si pasojë e shkeljes së Garancive të përcaktuara në Nenin 7.2 me përjashtim të Garancive të referuara në (i) këtu më sipër, për të paguar çdo shumë (kur i shtohet çdo shume të pagueshme sipas Nënëtit 3.3 (Rivlerësimi i Çmimit të Blerjes)) e cila do të tejkalone të total dyzet përqind (40%) të Çmimit të Blerjes;

8.3.4 Përgjegjësitë e Mundshme

në lidhje me çdo përgjegjësi që është e mundëshme përvçese nëse, dhe deri në momentin kur, kjo përgjegjësi e mundshme hëher përgjegjësi aktuale dhe e shlyeshme dhe e pagueshme (me kusht që kjo nuk duhet të ndalojë Blerësin që të paraqesë një Njoftim Pretendimi në lidhje me këtë përgjegjësi të mundshme përparrë se të bëhet përgjegjësi aktuale)

8.3.5 Dispozitat në Llogaritë

në lidhje me çdo pretendim nëse dhe në masën që përfshijen mbi bazën e së cilës ngrihet pretendimi ka një proviqjonim apo rezervimin përkates që është marrë parasysh për qëllim të përcaktimit të Vlerës Përfundimtare Neto të Aseteve për Mbylljen.

8.3.6 Dhënia e Informacionit

në lidhje me çdo pretendim kur Sitësi e ka informuar Blerësin, në mënyrë specifikë dhe të drejtë, përfshijen si pasojë e së cilës ngrihet ky pretendim në Shtojcën Informuese.

8.3.7 Neglizhencë Serioze dhe Keqveprimi i Qëllimshëm

në lidhje me çdo Dëmë nëse ky dëm nuk do të kishte ndodhur, përvçese në rast të:

a) neglizhencë serioze apo keqveprimit të qëllimshëm të Blerësit pas Mbylljes;

b) ndryshimeve në llogaritë financiare: ndryshimeve në rregullat, bazat apo praktikat e mbajtjes së llogarive financiare të Blerësit, nëse aplikohen apo hyjnë në fuqi pas Mbylljes;

8.3 Siguracioni

në lidhje me çdo pretendim në masën që çdo Dëmë që shkaktohet si pasojë e ngjarjes në bazë të së cilës ngrihet një pretendim i tillë (pasi të llogariten Tatimet mbi të ardhurat nga siguracioni por duke i dhënë vlerë në llogaritjen e këtij Tatimi çdo lehtësimi tatimor të aplikueshëm në lidhje me këtë Dëm) (i) në fakt është mbuluar nga të ardhurat e siguracionit të marra nga OSSH-ja apo Blerësi, përfshirë llogari të këtij Dëmi, apo (ii) do të ishtë mbuluar në mënyrë të tillë nëse pretendimi do të ishte paraqitur në përputhje me rregullat përkatese të kontratës së sigurimit.

8.3.9 Përfitimi Neto

në lidhje me çdo pretendim përfshirë Dëmët të pësuar nga Blerësi në masën e çdo përfitimi neto korrespondues që rezulton në favor të Blerësit në lidhje me të

8.3.10 Pranimet e Blerësit

Blerësi pranon dhe miraton (përvec Garancive të shprehura në këtë MBA) që:

i) Blerësi nuk është nxitur që të hyjë në këtë MBA mbi bazën e, dhe nuk është mbështetur në ndonjë deklaratë, garanci, premtim, mirëkuptim apo deklaratë verbale të çfarëdo natyre të bëre nga Shitësi apo agjentët, personeli, apo këshillues të tij, përvec atyre të referuar shprehimisht në këtë MBA;

ii) Blerësi ka kryer inspektimin dhe due diligenc-ën e tij në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e tij individuale, me shpenzimet e veta, përparrë se të hynte në këtë MBA; dhe

iii) Blerësi ka marrë të gjithë këshillën e nevojshme të pavarur në masën e gjykuar prej tij si të kënaqëshme dhe ka blerë Aksionet plotësisht nën përgjegjësinë vetjake;

8.4 Minimizimi i Dëmit

Të dyja Palët duhet që të bëjnë të mundur marrjen e të gjitha masave të arsyeshme dhe dhënien e të gjithë asistencës së arsyeshme me qëllim minimizimin e çdo Dëmi, që në të kundërt mund të sillte përgjegjësi në lidhje me çdo pretendim sipas kësaj MBA-je.

8.5 Ngritja e Pretendimeve

8.5.1 Njoftimet

Nëse Blerësi merr dijeni për çdo rrethanë që mund të shkaktojë grijen e një pretendimi kundër Shitësit sipas kësaj MBA-je, Shitësit duhet që t'i jetet njoftim për këtë fakt sa më shpejt që në mënyrë të arsyeshme të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre (3) muaj nga zbulimi përfundimtar i këtyre rrethanave nga Blerësi.

Çdo pretendim për Dëm sipas Nenit 8 duhet që të ngritet duke i dhënë Shitësit një njoftim me shkrin mbi pretendimin në fjalë, ku specifikohen (në hollësi të arsyeshme) rrethanat mbi të cilat ngritet pretendimi, natyrën e pretendimit dhe shumën e pretenduar në lidhje me të (ku të përshkrubet në hollësi të arsyeshme përllogaritja e pretenduesit përmes humbjes që ai pretendon të ketë pësuar), dhe ky njoftim do të përbëjë Njoftimin e Pretendimit.

8.5.2 Inspektimi nga Shitësi

Pa paragjikuar vlefshimërinë e pretendimit apo të pretendimit në fjalë të presupozuar, Blerësi duhet që të lejojë, dhe të bëjë të mundur që OSSH-ja të lejojë, Shitësin, si dhe ekspertët e tij financiarë dhe këshilltarët e tij profesionistë që të inspektojnë me shpenzimet e tyre ngjarjen apo rrethanat që prezupozohet të ketë shkaktuar ngritjen e këtij pretendimi, gjithashu nëse dhe në ç'masë duhet të paguhet ndonjë shumë në lidhje me këtë pretendim dhe për këtë qëllim Blerësi duhet që të japë, dhe të bëjë të mundur që OSSH-ja të japë, me kusht që të jenë paguar të gjitha kostot dhe shpenzimet e arsyeshme, të gjithë informacionin dhe asistencën e nevojshme, përfshirë këtu aksesin në masën e arsyeshmës në ambjentet dhe personelin e saj, mbi bazë e një njoftimi të dhënë pesë (5) Ditë Biznesi përparrë, dhe të drejti për të ekzaminuar dhe kopjuar apo fotografuar çdo aset, llogari, dokument dhe regjistrim, deri në masën që konsiderohet në mënyrë të arsyeshme të jetë e lidhur me objektin e pretendimit në fjalë dhe kërkesën e arsyeshme të Shitësit, eksperti të tij financiarë apo këshilltarëvë profesionistë. Shitësi pranon që të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit dhe t'a përdorë atë vetëm për qëllimet e pretendimit në fjalë.

8.5.3 Përgjegjësia ndaj/ Pretendimet e, Palëve të Tretë

Nëse pretendimi në fjalë ngritet si pasojë e, apo në lidhje me, një pretendim nga një pale të tretë, apo përgjegjësie ndaj saj, atëherë:

a) nuk do të merret përsipër asnjë përgjegjësi nga ana e Blerësit, apo përmes llogari të tij, dhe pretendimi nuk do të negociohet, shlyhet apo zgjidhet pa miratimin paraprak me shkrin të Shitësit, miratim i cili nuk duhet të mohohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme;

b) Shitësi ka të drejtë që të marrë pjesë, me shpenzimet e veta dhe këshilltarin e përzgjedhur prej tij, në mbrojtjen e Blerësit ndaj pretendimeve të paleve të tretë. Në këtë rast, Blerësi duhet t'i krijojë Shitësit dhe këshilltarit të tij mundësinë për të dhënë opinionin e tyre dhe për të kundërshtuar (kjo e drejtë nuk duhet të ushtronhet në mënyrë të paarsyeshme) në lidhje me mënyrën e mbrojtjes ndaj pretendimit. Blerësi duhet që në mënyrë të arsyeshme t'a mbajë Shitësin të informuar, mbi ecurinë e pretendimeve të paleve të tretë dhe mbrojtjes përkatëse, dhe sa më shpejt që të jetë e arsyeshme duhet që t'i japë Shitësit kopjet e në gjitha njoftimeve, komunikimeve me shkrin dhe depozitimeve (përfshirë dokumentat e përdorura në gjykate), të konsideruara thelbësore, të bëra nga,

apo pér illogari tē palëve që janë subjekti tē pretendimit nē fjalë. Shitësi duhet që tē ruajë konfidencialitetin e këtij informacioni.

8.6 Dëmshpérblimi Paraprak

Nëse, përparrë se Shitësi tē ketë paguar ndonjë shumë pér shlyerjen e çdo pretendim nē lidhje me këtë MBA, Blerësi dëmshpérblehet apo i njihet e drejtë pér t'u dëmshpérblir (qoftë përmes pagimit, zbritjes, kreditimit, lehtësimit tē detyrimeve apo nē ndonjë mënyrë tjetër) nga një palë e tretë me një shumë që i referohet objektit tē pretendimit, Blerësi duhet tē krijojë mundësinë që tē merren tē gjitha masat e arsyeshme pér ekzekutimin e këtij dëmshpérblimi dhe shuma përkatëse (pasi t'i janë zbritur shpenzimet e arsyeshme, tē bëra pér përfitimin e dëmshpérblimit, dbe çdo Tatim që aplikohet mbi këtë dëmshpérblim, duke marrë parasysh lehtësirat tatimore që aplikohen mbi objektin e pretendimit) duhet tē përdoret përs tē pakësuar apo shlyer, sipas rastit, këtë pretendim, sidoqoftë kuptohet që (a) Blerësi duhet tē njoftojë Shitësin pér këtë pretendim, sipas MBA-së, menjëherë apo tē ketë ndodhur ngjarja mbi tē cilën ngrihet pretendimi dhe përparrë se tē ketë realizuar ndonjë dëmshpérblim nga palët e treta, dbe (b) nëse njoftimi nē fjalë, i pretendimit, është bërë brenda afateve kohore tē përcaktuara nē Nenin 8.3.1, ky pretendim do t'i ngarkohet Shitësit dbe do tē dëmshpérblehet po prej tij, por vetëm nëse janë marrë te gjitha masat e arsyeshme pér ekzekutimin e këtij dëmshpérblimi, pasi tē janë zbritur tē gjitha dëmshpérblimet tashmë tē shlyera (siç parashikohet më sipër).

8.7 Dëmshpérblimi i Mëvonshëm

Nëse Shitësi ka paguar pér shlyerjen çdo pretendimi nē lidhje me këtë MBA dbe Blerësi vetëm si rrjedhojë e këtij veprimi dëmshpérblehet (qoftë përmes pagimit, zbritjes, kreditimit, lehtësimit tē detyrimeve apo nē ndonjë mënyrë tjetër) nga një palë e tretë me një shumë që i referohet objektit tē pretendimit, Blerësi duhet që t'i paguajë Shitësit një shumë tē barabartë me (i) shumën e përfituar prej palëve tē treta pasi tē janë zbritur shpenzimet e arsyeshme, tē bëra pér përfitimin e dëmshpérblimit, dbe çdo Tatim që aplikohet mbi këtë dëmshpérblim, duke marrë parasysh lehtësirat tatimore që aplikohen mbi objektin e pretendimit, ose (ii) nëse është me e vogël, shumën që Shitësi i ka paguar Blerësit më përparrë, duke zbritur Tatimin e aplikueshëm.

8.8 Tatimi

Në përllogaritjen e përgjegjësisë së Shitësit pér çdo shkelje tē kësaj MBA-je, duhet tē merret parasysh që shumë Tatimi (nëse ka tē tillë), e cila nē tretëna tē tjeru do tē ngarkohej mbi Blerësin, por që në fakt është zbritur apo shuar si rrjedhojë e ndodhjes së ngjarjes që është objekt pretendim apo çdo shumë Tatimi tē rimbursuar pér këtë asye.

8.9 Pagesat

Pagimi i shumave që Shitësi i detyrohet Blerësit sipas Nenit 8 duhet që tē bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita kur vlera e përgjegjësisë së Shitësit duhet tē jetë përektuar përfundimisht mbi bazën e një marrëveshje me mirëkuptim midis Palëve apo një vendimi tē ekzekutueshëm tē Gjykatës së Arbitrazhit.

8.10 Pretendimet që duhen zgjidhur sipas Nenit 13

Çdo dbe tē gjithë pretendimet pér Dëme si pasojë e kësaj MBA-je apo nē lidhje me tē do tē zgjidhen nē përpunje më Nenin 13, në vijim.

9. PËRQINDJA E NGELUR E AKSIONEVE NË OSSII

Blerësi pranon faktin që Shitësi do tē transferojë paketën e ngelur tē aksioneve nē kapitalin aksioner tē OSSH-së, e cila nuk është transferuar nē kuadër tē Transaksionit, subjekteve tē meposhtme:

a) subjekteve, paraprakisht tē shpronësuar nga toka apo ndërtesar, me një vlerë tē barabartë me vlerën e tokës dbe/ose ndërtesave, vlerësim i cili do tē bëhet nē përpunje me legjislacionin në fuqi, pér kriteret e vlerësimit tē pasurisë shtëtërore, subjekt privatizimi;

b) punonjësve tē OSSH sh.a., nē shkëmbim tē bonove tē privatizimit dbe/ose letrave tē privatizimit tē personave tē persekuar, tē zotëruara nga këto punonjës, përfshirë këtu prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët e tyre.

Përqindja, mekanizmi dbe afatet e transferimi tē aksioneve që do t'u ofrohen subjekteve, paraprakisht tē shpronësuar nga toka apo ndërtesar, dbe punonjësve, do tē përcaktohen me Vendim tē Këshillit tē Ministrave.

9.1 Punonjësit

Palët pranojnë që METE do t'u ofrojë punonjësve (të cilët punojnë në OSSH pas përfundimit të privatizimit, dhe/ose, te cilët pas vitit 1992, kanë punuar për të paktën pesë (5) vjet për KESH sh.a, dhe/ose OSSH-në, ose qdo shoqëri të tyre bijë, apo kanë qënë anëtarë në organet drejtuese të KESH sh.a, dhe/ose të OSSH-së) aksione të OSSH-së që janë në pronësi të Shitësit pas Mbylljes.

9.2 Pronarët e Mëparshëm

Palët pranojnë që METE do të përaktojë një përqindje që do të porcionalizohet me qëllim që të mundësohet kompensimi i drejtë i pronarëve të mëparshëm të tokës/ndërtesave. Çdo pronari të mëparshëm do t'i ofrohen aksione më vlerë të njëjtë me vlerën e tokës/ndërtesave, vlerë e cila do të përllogaritet në përpunje me vlerat e propozuara nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit, dbe që është miratuar apo do të miratolet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Vlerat e kompensimit janë përcaktuara dhe miratuar tashmë për pjesën me të madhe të zonave në Shqipëri dhe prijet që deri në fund të vitit 2007 të janë propozuar dhe miratuar vlerat e kompensimit për të gjitha zonat.

9.3 Aksionet e Ngelura

Blerësit i jetet një e drejtë parablerje (në formën e opzionit për blerje) për aksionet e ngelura të OSSH-së, të cilat nuk i transferohen subjekteve, paraprakisht të shpronësuar nga toka apo ndërtesat, dhe punonjësve të OSSH-së, me të njëjtin çmim blerjeje për aksion dhe sipas kushteve dhe afateve të njëjta me ato të përcaktuara nc këtë MBA (duke marrë parasysh rivlerësimin sipas Nemit 3.3 më sipër). E drejta e parablerjes do të shuhet një (1) vit pas përfundimit të procedurës për transferimin e aksioneve të cilat u janë ofruar pronarëve të mëparshëm të tokës/ndërtesave dhe punonjësve.

Pas shuarjes së periudhës për ushtrimin e të drejtës së parablerjes, aksionet e ngelura, të cilat nuk janë blerë nga Blerësi, do të vazhdojnë të mbeten në pronësi të METE-s. Mekanizmi dhe subjektet të cilëve do t'u transferohen këto aksione, do të përaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

10. ZGJIDHA E MARRËVESHJES

10.1 Zgjidhja me Marrëveshje të Përbashkët

Kjo MBA mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, duke hequr dorë nga Transaksi i një moment përpëra Datës së Mbylljes.

10.2 Zgjidhja e Marrëveshjes nga Shitësi

Kjo MBA mund të zgjidhet nga Shitësi në çdo moment përpëra Datës së Mbylljes, pasi të jetë njoftuar me shkrim Blerësi:

i) nëse ndonjë nga kushtet paraprake nën përgjegjësinë e Blerësit (që parashikohen në Nenin 4.2), nga i cili nuk është hequr dorë paraprakisht nga Palët, nuk është përbushur përpëra apo në Datën e Mbylljes (me përashtim të rastit kur Shitësi është përgjegjës për mospërbushjen e këtij Kushti Paraprak), apo nëse Blerësi kryen ndonjë shkelje tjetër të dëtyrimeve të tij thelbësore sipas kësaj MBA-je përpëra apo në Datën e Mbylljes;

ii) nëse shitja e Aksioneve nuk është realizuar përpëra apo në Datën e Mbylljes (apo në një datë të mëvonshme për të cilën Plalët kanë rënë dakort me shkrim) për arsyet e veprimit në mënyrën e gabuar Blerësit apo mosveprimit të tij;

iii) nëse ndodh një ndryshim Kontrolli tek Blerësi, kur ky është një shoqëri më objekt të veçantë, pa miratinin paraprak me shkrim të Shitësit;

iv) nëse është caktuar një likuidues apo një funksionar i ngjashëm për të gjitha apo për një pjesë të aseteve ose sipërmarrjeve të Blerësit, apo është lëshuar një vendim ose urdhër gjykate për prishjen e Blerësit, apo është ngritur një kërkësë për shpallje fulimentimi kundër Blerësit;

v) nëse Blerësi kryen një shkelje thelbësore të angazhimeve që parashikohen në Nenin 5.5 dhe 5.6;

vi) nëse Blerësi kryen një shkelje thelbësore të Garancive që parashikohen në Nenin 7.1, më sipër; dhe

vii) në rastin e një Ndryshimi Thelbësor Përkeqësues.

10.3 Zgjidhja ngu Blerësi

Kjo MBA mund tē zgjidhet nga Blerësi nē çdo moment përpala Datës së Mbylljes, pasi tē jetë njoftuar me shkrim Shitësi:

i) nëse ndonjë nga Kushtet Paraprake nē përgjegjësinë e Shitësit (që parashikohen nē Nenin 4.1), nga i cili nuk është hequr dorë paraprakisht nga Palët, nuk është përbushur përpala apo nē Datën e Mbylljes (me përashtim tē rastit kur Blerësi është përgjegjës pér mospërbushjen e këtij Kushti Paraprak), apo nëse Shitësi kryen ndonjë shkelje tjetër tē detyrimeve tē tij thelbësore sipas kësaj MBA-je përpala apo nē Datën e Mbylljes;

ii) nëse shitja e Aksioneve nuk është realizuar përpala apo nē Datën e Mbylljes (apo nē një datë tē mëvonshme pér tē cilën Plaët kanë rënë dakort me shkrim) pér arsyet tē veprimit nē mënyrën tē gabuar tē Shitësit, apo mosveprimit tē tij;

iii) nëse Shitësi kryen një shkelje thelbësore tē angazhimeve që parashikohen nē Nenin 5.1 deri nē Nenin 5.3 dbe si rrjedhojë shkaktor një humbje nē Grupin e Blerësi apo nē OSSH me një vlerë që e tejkalon shifrën dhjetë milion Euro (EUR 10,000,000) dbe duke shkaktuar Ndryshim Thelbësor Përkeqësues;

iv) nëse Shitësi kryen një shkelje thelbësore tē Garancive që parashikohen nē Nenin 7.2 (a) nē lidhje me çdo Garanci që parashikohet nē Nenin 7.2.1 (Mbarëvajtja), Nenin 7.2.2 (Aksionet e Lira nga çdo Barrë) apo Nenin 7.2.3 (Pronar i Ligjshëm), dbe (b) nē lidhje me Garancitë që parashikohen nē Nenin 7.2 përvëç atyre tē parashikuara nē (a), që shkaktor një humbje nē Grupin e Blerësi apo OSSH me një vlerë që e tejkalon shifrën dhjetë milion Euro (EUR 10,000,000); dbe

v) në rastin e një Ndryshimi Thelbësor Përkeqësues.

E drejtë e seviles Pale pér tē zgjidhur këtë MBA nuk do tē paragjykohet nē lidhje me tē drejtat, detyrimet apo përgjegjësitë e Palëve sipas kësaj MBA-je.

11. KONFIDENCIALITETI

11.1 Palët duhet tē trajtojnë nē mënyrë reptyësish konfidenciale tē gjithë informacionin e marrë apo tē siguruar si rrjedhoje e hyrjes nē këtë MBA, apo veprimit sipas saj, dbe që lidhet me:

a) negociatat nē lidhje me këtë MBA apo dokumentat e referuar nē tē;

b) dispozitat apo çështjet e kësaj MBA-je apo tē dokumentave te referuar nē tē; apo

c) Shitësin ose Blerësin.

11.2 Shitësi ose Blerësi mund t'i japë një pale tē tretë një informacion, që nē rrethana tē jera do konsiderohej konfidencial, nëse, dbe vetëm nē masën që:

a) kërkohet sipas legjislacionit tē çdo juridikzioni përkates apo pér qëllime tē çdo procedure tē ligjshme;

b) kërkohet nga një irregulator apo organ qeveritar;

c) ky informacion i bëhet i ditur, mbi baza reptyësish konfidenciale, këshilltarëve profesionistë, auditorëve apo bankierëve tē këtij personi tē tretë, me qëllim këshillimin e këtij personi tē tretë mbi këtë MBA, me kusht që ky zhulum informacioni t'i nënshtrohet kushtetë tē Nenit 11.1;

d) informacioni është bërë publik më mënyra tē ndryshme, sidoxoftë jo përmes kësaj pale tē tretë;

e) Pala tjetër ka dhënë paraprakisht miratimin e saj me shkrim; apo

f) kërkohet me qëllim që Pala tē ketë mundësi që tē ushtrojë apo tē vërv nē vënd tē drejtat e saj sipas kësaj MBA-je,

me kusht që informacioni që bëhet i ditur sipas Nenit 11.2 (a) dhe Nenit 11.2 (b) tē jepet vetëm pas konsultimeve (kur është praktikisht e mundur) me Palën tjetër.

11.3 Angazhimet pér konfidencialitet, sipas këtij nenit, do tē qëndrojnë nē fuqi pér një periudhë prej tre (3) vitesh që nga Data e Nënshkrimit tē kësaj MBA-je.

12. NJOFTIMET

12.1 Në varësi tē Nenit 12.2, astijëru nga Palët nuk do tē bëjë apo lëshojë (qoftë përpala apo pas Mbylljes) ndonjë njoftim, qarkore apo formë tjetër publikimi nē lidhje me ndonjë çështje tē referuar nē këtë MBA pa miratimin paraprak me shkrim tē Palës tjetër mbi formën dbe përbajtjen e këtij njoftimi. Ky angazhim do tē jenë i vlefshëm pér një periudhë prej tre (3) vitesh që nga Data e Nënshkrimit tē kësaj MBA-je.

12.2 Neni 12.1 nuk do të aplikohet ndaj njoftimeve, qarkoreve apo forme tjeter publikimi:

a) të këruar sipas legjislacionit të çdo juridiksi përkatës apo rregulloret ose akter e çdo rregulatori apo organi qeveritar. Në këtë rast, Pala që bën apo dërgon njoftimin, qarkoren apo çdo publikim tjeter, duhet që, për aq sa është praktikisht e mundur, të informojë Palen tjeter përmes formës së përbajtjes e këtij njoftimi; ose

b) të bërë nga Shiteti në mjetet mediatike në kuadër të detyrimit të tij të përgjithshëm përmes informuar publikun mbi çështje të një interesit publik, siç është rasti i emrit të Blerësit dhe procesi i privatizimit; ose

c) të bërë në formë e rënë dakort nga Palët sipas Nenit 12.1, më sipër, apo të dërguar pas Mbylljes, nga osc përmes llogari të Blerësit me qëllim këshillimin e mediave, punonjësve, klientëve, furnizuesve apo agjentëve të OSSH-së në lidhje me Transaksionin.

13. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje (përfshirë këtu çdo pretendim përmes shaktimit të Nenit 8 të kësaj MBA-je) midis tyre dhe që lind si pasojë e kësaj MBA-je apo në lidhje me të, do të zgjidhet në përpunim me dispozitat e këtij Neni 13.

13.1 Ligji i Zbatueshëm

Kjo MBA do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet sipas Legjislacionit dhe çdo akti tjeter që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë.

13.2 Zgjidhja me Mirëkuptim

Secila Palë duhet të përpigjet që të zgjidhë me mirëbesim dhe përgjegjësinë e duhur mosmarrëveshjet që lindin midis tyre si pasojë apo në lidhje me këtë MBA.

13.3 Arbitrazhi

Në varësi të Nenit 13.2, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin si pasojë apo në lidhje me këtë MBA do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndérkombëtare të Tregtisë ("Rregullat e DHNT-së") nga një trup prej tre (3) arbitrash ("Gjykata e Arbitrazhit"), të caktuar në përpunim me Rregullat e DHNT-së.

Breda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga komfirmimi i tyre, arbitrat e caktuar nga Palët do të zgjedhin sebashek Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit i cili duhet që të komfirmohet nga Gjykata Ndérkombëtare e Arbitrazhit. Nëse në këtë mënyrë nuk arrihet zgjedhja e Kryetarit, atëherë Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit do të zgjidhet në përpunim me Rregullat e DHNT-së.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Vienë, Austri. Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në gjuhën Angleze.

14. TË NDRYSHME

14.1 Njofimet

Të gjitha komunikimet, njofimet dhe informimet e kërkuar apo të lejuara sipas kësaj MBA-je do të bëhen më shkrim në gjuhën Angleze, dhe do të jepen dorazi, me postë me rekomandim apo të parapaguar me regjistrim (me komfirmim në kthim), me shërbim korrieri brenda natës që siguron konfirmim përmes dorëzimit apo me fax, në adresat e mëposhtme, përvet rastit kur dhe deri në momentin që secila nga Palët njofson Palen tjeter në përpunim me këtë nen 14.1, përmes adresës:

Për Shqipësin:

Ministri Genç Ruli

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Republikës së Shqipërisë

Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2, Tirana - Albania

Fax : +355 4 234 818

Për Blerësin:

Mr. Vladimir Schmalz, Drejtës i Shkrirjeve dhe Blerjeve

ČEZ, a.s.,

Duhová 2/1444, Praha 4, 140 53 - Czech Republic

Fax : +420 211 042 011

14.2 Shpenzimet

Secila nga Palët do të mbulojë shpenzimet e veta në lidhje negociajat, lidhjen dhe Mbylljen e të gjitha dokumentave me fuqi juridike përmes shqipërisë.

Qdo taksë pulle apo tarifë ligjore që duhet të paguhet si pasojë e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje dhe transferimit të Aksioneve do të jenë në ngarkim të Blerësit.

14.3 Tërsia e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje (sëbashku me të gjithë dokumentacionin e referuar në të apo të ekzekutuar përpara apo në Mbyllje) përbën MBA-në dhe marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson qdo marrëveshje, angazhim apo sipërmarrje të mëparshme në lidhje me këtë objekt si dhe ka prioritet ndaj tyre.

14.4 Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj MBA-je nuk do të jetë i vlefshëm përvëçse kur bëhet me shkrim dhe nënshkrubet nga Palët.

14.5 Kalimi i të Drejtave

Kjo MBA krijon detyrime dhe përfitime ligjore ndaj Palëve, trashëgimtarëve të tyre dbe personave të cilëve u kalohen të drejta sipas saj.

Me përgjashtim të sa parashikohet në Nenin 6.4, Blerësi nuk mund të kalojë apo transferojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate, në tërsi ose në veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit, miratim i cili nuk duhet të mohohet pa arsy.

14.6 Pavlefshmëria e Pjesëshme

Nëse një pjesë e kësaj MBA-je është apo bëhet e pavlefshme apo e humbet fuqinë e saj detyruar, Palët vazhdojnë t'i nënshtronë efektit detyrues të pjesës tjetër të saj. Në këtë rast, Palë përkutëse duhet që të zëvendësoj pjesën e pavlefshme apo që ka humbur fuqinë detyrues, me dispozita të vlefshme dbe me fuqi detyruese dbe qëllimi i të cilave, duke pasur parasysh përmbytjen dbe qëllimin e kësaj MBA-je, është maksimalisht i ngjashëm me qëllimin që kërkobet të arrinë me pjesën e pavlefshme apo që ka humbur fuqinë detyrues.

14.7 Heqja Dorë nga Imuniteti për Shkak te Sovranitetit

Shitësi deklaron dbe garanton se hyrja e tij në këtë MBA dbe përbushja e detyrimeve që parashikohen në të, përbëjnë veprime tregtare dbe jo akte publike ose qeveritare dbe se nuk ka të drejtë të pretendojë për imunitet në procedimet gjyqësore që lidhen me të ose asetet e tij, duke u bazuar në sovranitetin e tij apo arsyen tjetër sipas çdo ligji apo në çfarëdo juridiksioni ku mund të ngrihet një padi për ekzekutimin e një detyrimi që lind ose që lidhet me këtë MBA. Edhe nëse Shitësi ose një aset i tij kanë ose mund të fitojnë një të drejtë imuniteti në lidhje me kompensimet, procedimet ligjore, masa për sigurimin e padisë, masa të tjera apo ekzekutim të vendimit, në bazë të sovranitetit ose të një arësyeje tjetër, Shitësi shprehurisht beq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga këto të drejta për imunitet në kuptim të detyrimeve që lindin ose që lidhen me këtë MBA.

14.8 Heqja dorë

Qdo beqje dorë nga një Palë e caktuar për të ushtruar një apo disa nga të drejtat që i njihen sipas kësaj Marrëveshje nuk do të trajtohet si heqje dorë në mënyrë përfundimtare dbe të përhershme nga ushtrimi i kësaj të drejte.

14.9 Valuta

Me përgjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe, çdo dbe të gjitha pagesat e referuara në këtë Marrëveshje do të bëhen në Euro.

14.10 Gjuha

Kjo MBA është përgatitur në gjuhën Angleze. Kesaj do ti bëhet një perkthim pune ne gjuhen shqipe per qellim te miratimeve te ndryshme nga ana e Shitësit. Në rast te pabarazise midis tekstit Anglisht te kësaj MBA-je dbe perkthimit ne shqip, teksti në Angleisht ka prioritet.

Lidhur në Tiranë, më 11 Mars 2009 në gjashtë (6) kopje origjinale nga:

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, NË CILËSINË E PËRFAQËSUESIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

ČEZ, a.s.

ANEKSI 1

Kopje të transferimit të aksioneve të OSSH-së nga KESH tek METE

ANEKSI 2

Oferta teknike dhe financiare e Blerësit

ANEKSI 3

Lista e Aseteve dhe Detyrimeve të OSSH-së

ANEKSI 4

Lista e Punonjësve të OSSH-së

ANEKSI 5

Raporti i Kushteve Mjedisore Bazë të Rrjetit të Shpërndarjes

ANEKSI 6

Lista e Këshillit Mbikqyrës të OSSH-së

ANEKSI 7

Dokumentat Organizativë të OSSH-së

ANEKSI 8

Statuti i OSSH-së

ANEKSI 9

Lista e Çështjeve Gjyqësore

ANEKSI 10

Të dhëna të hollësishme mbi Rritjet e Kapitalit

ANEKSI 11

Deklaratë Rregullatore

ANEKSI 12

Shtojca Informuese

ANEKSI 13

Udhëzimet për Përllogaritjen e VNA-së në Mbyllje

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 13.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë



URDHËR

Nr. 954 Date 22/10/2014

PËR

REGJISTRIMIN E 100 PËR QIND TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “OSHEE ” SH.A TIRANË NË PRONËSI TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjet Nr. 7926, datë 20.04.1995, Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregtare”, i ndryshuar, Ligjet Nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare , Ligjet Nr. 114/2014 “ Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ A.S;

URDHËROJ:

1. Regjistrimin e 100 për qind të aksioneve të shoqërisë “OSHEE ” sh.a Tirana në pronësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
2. Në zbatim të Ligjet Nr. 9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Seksioni III, regjistrimi filletar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ



SHTOJCA 6

Forma e Marrëveshjes së Transferimit të Aksioneve

MARRËVESHPJA E BLERJES SË AKSIONEVE

MIDIS

ČEZ, a. s.

SHITËSI

DHE

Ministria Shqiptare e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) që
vepron në emër të Republikës së Shqipërisë

BLERËSI

Datë [16, Tetor] 2014

Kjo MARRËVESHJE E BLERJES SË AKSIONEVE (kjo "Marrëveshje") lidhet më [16, Totor, 2014] ndërmjet palëve vijuese:

ČEZ, a. s., shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës Çeke, me seli në Prague 4, Duhová 2/1444, Kodi Postar 140 53, numër identifikimi të shoqërisë Nr. 452 74 649, regjistruar në Seksionin B, Dosja 1581 të Regjistrat Tregtar të mbajtur pranë Gjykatës së Qytetit të Pragës ("Shitësi"),

dhe

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes e Republikës së Shqipërisë që vepron në të Republikës së Shqipërisë, me seli zyrtare në Bulevardin Dëshmorët e Kombit, nr. 2, 1001, Tiranë, Republika e Shqipërisë ("Blerësi").

Deklarime hyrëse

MEQËNËSE, më [të vendoset data] Shitësi dhe Blerësi kanë lidhur një marrëveshje zgjidhjeje me mirëkuptim ("Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim") sipas së cilës kanë rënë dakord që Shitësi do t'i shesë Blerësit Aksionet:

NË KËTO KUSHTE, Palët bien dakord si vijon:

NENI 1 PËRKUFIZIMET

1.1 Përveç termave të përkufizuara gjetkë në këtë Marrëveshje, termat e vendosura më poshtë kanë këto kuptime në këtë Marrëveshje:

“Administrator” do të thotë një administrator i përkohshëm i Shoqërisë, i caktuar dhe mbikqyrur nga ERE sipas vendimit nr. 5/2013 datë 21 janar 2013 sipas të cilit Shoqëria u vendos nën administrimin e përkohshëm të ERE pas heqjes së licensave të Shoqërisë për shpérndarjen e energjisë elektrike dhe furnizimin me pakicë të publikut.

“Shoqëria” do të thotë CEZ Shpërndarje Sh.A., një shoqëri aksionare që ushtron veprimtarinë sipas ligjeve të Shqipërisë, themeluar më datë 8 qershor 2007 dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 38587 datë 19.06.2007, me seli të regjistruar në Rr Abdyl Frashëri EGT Tower 12P/1, Tiranë, Shqipëri, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K72410014H.

“Vendimi ERE” do të thotë miratimi paraprak nga ERE i transferimit të Aksioneve tek Blerësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

“Autorizimi i Bashkimit” do të thotë miratimi i transferimit të Aksioneve nga Shitësi tek Blerësi nga Autoriteti i Konkurrencës.

“Palë” do të thotë si Shitësi ose Blerësi dhe “Palët” do të thotë Shitësi dhe Blerësi bashkërisht.

“Aksionet” do të thotë 22,875,317 aksione të zotëruara nga Shitësi në Shoqëri.

“Regjistro i aksioneve” do të thotë regjistri i aksioneve që mbahet nga Shoqëria sipas nenit 119(3) të Ligjit shqiptar 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

“Data e nënshkrimit” do të thotë data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

NENI II SHITJA DHE BLERJA E AKSIONEVE

2.1 Brenda afateve dhe në zbatim të kushteve të parashikuara këtu, Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi Aksionet, transferimi i Aksioneve hyn në fuqi dhe përfundohet me regjistrimin e transferimit në Regjistrin e Aksioneve, që provon se Blerësi është zotëruesi i vetëm i Aksioneve.

2.2 Blerësi do të sigurojë që transferimi i Aksioneve sipas kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi tek Blerësi do të regjistrohet në Regjistrin e Aksioneve në Datën e Nënshkrimit menjëherë pasi kjo Marrëveshje të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe do t'i japë Shitësit një kopje të Regjistrat të Aksioneve që provon një transferim të tillë në Datën e Nënshkrimit.

2.3 Blerësi menjëherë pas Datës së Nënshkrimit do të depozitojë (dhe do të kujdeset që Shoqëria të depozitojë) aplikimin për regjistrimin e transferimit të Aksioneve nga Shitësi tek Blerësi sipas kësaj Marrëveshje në Regjistrin shqiptar Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ("QKR").

2.4 Blerësi pranon dhe bie dakord që Shitësi nuk jep asnjë siguri ose garanci, të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me ndonjë çështje që lind në lidhje me Shoqërinë dhe/ose Aksionet dhe/ose transaksionet e referuara këtu, duke përfshirë vlerën e Shoqërisë, gjendjen e saj financiare, lejet (duke përfshirë cdo leje, licensë, pëlqim, miratim, certifikatë, regjistrim apo autorizime të tjera) dhe/ose çdo çështje tjetër, ngjarje ose gjë që lidhet me Shoqërinë, themelimin e saj, aftësinë e saj paguese, pronësinë, biznesin, veprimitarinë, asetet, prospektet, përgjegjësitë, borxhet dhe/ose detyrimet ose çështje të tjera të mundshme. Pa u kufizuar në ndonjë mënyrë sa më sipër, Shitësi heq dorë nga çdo garanci, të shprehur apo të nënkuptuar, verbale apo të shkruar, përsye tregtimi apo përshtatshmëri për ndonjë qëllim të veçantë në lidhje me Shoqërinë, duke përfshirë biznesin, veprimitarinë, asetet, prospektet, përgjegjësitë, borxhet dhe/ose detyrimet e tjerë të saj dhe Blerësi bie dakord dhe pranon këtë heqje dorë.

2.5 Pa cënuar Seksionin 6.2, Blerësi më tej pranon që Shitësi nuk do të jetë i detyruar dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi t'i japë Blerësit ndonjë informacion që lidhet me Shoqërinë dhe/ose me Aksionet dhe/ose me transaksionet e referuara këtu, duke përfshirë vlerën e Shoqërisë, gjendjen e saj financiare, lejet (duke përfshirë cdo leje, licensë, pëlqim, miratim, certifikatë, regjistrim apo autorizime të tjera) dhe/ose çdo çështje tjetër, ngjarje ose gjë që lidhet me Shoqërinë, biznesin, veprimitarinë, asetet, prospektet, përgjegjësitë, borxhet dhe/ose detyrimet e tjerë; Blerësi pranon dhe bie dakord që Shitësi nuk ka asnjë informacion në lidhje me gjendjen financiare, operacionale apo çdo gjendje tjetër të Shoqërisë dhe se me vazhdimin e blerjes së Aksioneve të parashikuar sipas kësaj, Blerësi e bën këtë gjë në rrezikun dhe përgjegjësinë e tij. Si rrjedhim, Blerësi do të blejë dhe bie dakord të blejë Aksionet "sìç janë" "ku janë" dhe "me të gjitha të meta".

NENI III ÇMIMI I BLERJES DHE PAGESA

3.1 Blerësi do të paguajë Shitësit çmimin e blerjes për Aksionet në shumën prej 1 EURO.

NENI IV VEPRIMET GJATË, PARA DHE PAS DATËS SË NËNSHKRIMIT

4.1 Në Datën e Nënshkrimit dhe para nënshkrimit të Marrëveshjes nga Shitësi, Blerësi duhet t'i tregojë Shitësit se kushtet vijuese janë përbushur:

- (a) MZHETS është autorizuar rregullisht nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë për të nënshkuar Marrëveshjen në emër të Republikës së Shqipërisë;
- (b) Të jetë lëshuar një Miratim Bashkimi përfundimtar, i zbatueshmë dhe efektiv; dhe
- (c) Vendimi i ERE të jetë miratuar në pëlgim të plotë të Shitësit.

4.2 Shitësi nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjës për përbushjen e kushteve të listuara në Seksionin 4.1, të cilat do të janë vetëm në përgjegjësinë e Blerësit.

4.3 Njëkohësisht me nënshkrimin e Marrëveshjes nga Shitësi, Shitësi do t'i japë Shoqërisë, me një kopje për Blerësin, letrat e dorëheqjes së përfaqësuesve të Shitësit nga detyrat e tyre në organet e Shoqërisë me efekt nga Data e Nënshkrimit. Blerësi merr përsipër të miratojë në Datën e Nënshkrimit një vendim, si aksioner i vetëm i Shoqërisë, në lidhje me pranimin e dorëheqjeve. Blerësi do të bëjë të mundur që Shoqëria të regjistrojë pranë QKR-së brenda 3 ditëve pune pas Datës së Nënshkrimit, fakin që përfaqësuesit përkatës të Shitësit në organet e Shoqërisë kanë dhënë dorëheqjen dhe se dorëheqja e tyre është pranuar. Brenda 1 ditë pune shtesë Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit prova të regjistrimit përfundimtar dhe efektiv të faktit se përfaqësuesit përkatës të Shitësit në organet e Shoqërisë kanë hequr dorë dhe se dorëheqja e tyre është pranuar. Për të shmangur çdo dyshim, dhënia nga Blerësi tek Shitësi e ekstrakti historik të Shoqërisë i lëshuar nga QKR, që konfirmon se përfaqësuesit respektivë të Shitësit në organet e shoqërisë janë q'regjistruar nga QKR dhe janë zëvendësuar nga përfaqësues të emëruar nga Blerësi, do të jetë një provë të mjaftueshme për këtë.

NENI V MOS-ZGJIDHJA

5.1 Asnjë nga Palët nuk mund të përfundojë apo të zgjidhë (për çfarëdo arsyë apo sipas ndonjë ligji apo teorie ligjore) këtë Marrëveshje pas nënshkrimit.

NENI VI MUNGESA E GARANCIVE NGA SHITËSI

6.1 Shitësi nuk do të jetë i detyruar të japë dhe nuk do të ketë përgjegjësi për ndonjë difekt faktik, ligjor apo të ndonjë natyre tjetër (të dukshëm apo të fshehur), në lidhje me Aksionet, Shoqërinë, asetet e Shoqërisë, duke përfshirë, pa kufizim, çështjet e ekzistencës së Aksioneve dhe të të drejtave që lidhen me Aksionet, me regjistrimin e duhur të Aksioneve në çdo regjistër të aplikueshëm, themelimin, aftësinë paguese, pronësinë mbi asetet, kushtet financiare, përputhjen me kërkesat rregullatore dhe mjedisore, taksat apo kushte të tjera karakteristike të cilësisë, si dhe Shitësi nuk do të ketë përgjegjësi për ndonjë humbje që i shkaktohet Shoqërisë apo Blerësit dhe në vazhdimin me blerjen e Aksioneve Blerësi mbështetet vetëm mbi informacionin që ai njeh bazuar në faktin se Administratori ka në ngarkim ekskuluziv veprimtarinë dhe menaxhimin e Shoqërisë.

6.2 Palët bien dakord se as Shitësi dhe as ndonjë prej degëve të tij nuk pranon ndonjë përgjegjësi dhe nuk bën ndonjë deklaratë apo garanci, të shprehur apo të nënkuptuar, në lidhje me vërtetësinë, saktësinë, tërësinë, mbështetjen, apo arsyeshmërinë e çdo informacioni të dhënë nga Blerësi në lidhje me Shoqërinë (duke përfshirë biznesin, veprimtarinë, asetet, prospektet, përgjegjësitë, borxhet, dhe/ose detyrimet tjerë) dhe/ose Aksionet dhe/ose transaksionet e referuara ose të parashikuara këtu; (ii) dhe as nuk do të jetë përgjegjës ndaj

Blerësit ose ndaj çdo personi tjetër në lidhje me këtë informacion ose përdorimin e tij, ose (iii) të jetë i detyruar të përditësojë këtë informacion të tillë ose të njoftojë Blerësin në lidhje më të ose të korrigojë çdo pasaktësi në lidhje në këtë informacion (edhe pse këto pasaktësi janë zbuluar pas dhënies së këtij informacioni)

NENI VII TË NDRYSHME

7.1 Blerësi dhe Shitësi bien dakord të ndërmarrin veprime të tjera që nuk janë parashikuar këtu dhe që mund të janë të nevojshme ose të dëshirueshme për përfundimin e shitjes së Aksioneve sipas afateve dhe kushteve të parashikuara këtu. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të Seksionit 7.1, Shitësi dhe Blerësi bien dakord të mos ndërmarrin, shkaktojnë ose lejojnë të ndërmerret ndonjë veprim, ose të kryejnë ose bëjnë që të kryhet ndonjë veprim që mund të ndikojë negativisht ose të pengojë kryerjen e transaksioneve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ose që kanë lidhje me Marrëveshjen, duke përfshirë mosmarrëveshjen që lidhet me ekzistencën, vlefshmérinë, apo përfundimin e Marrëveshjes ose që lidhet me detyrime jokontraktore apo të një natyre tjetër që lindin ose që kanë lidhje me këtë Marrëveshje ose pasojat e anullimit të saj do të zgjidhen përfundimisht sipas mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parashikuar në Marrëveshjen e Mirëkuptimit.

7.3 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

7.4 Në rast se një ose më shumë dispozita që përbahen në këtë Marrëveshje do të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme në ndonjë aspekt, për çdo arsy, atëherë në masën më të gjerë të lejueshme nga ligji, kjo pavlefshmëri, paligshmëri apo pazbatueshmëri nuk do të prekë dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe palët do të provojnë të përbushin efektet e dobishme të kësaj dispozite në mënyrë të tillë që të mos jetë e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme.

7.5 Kjo Marrëveshje do të jetë detyruese dhe në dobi të Palëve dhe të transferuesve të tyre të lejuar. Kjo Marrëveshje ose të drejtat dhe detyrimet e saj nuk mund të transferohen as nga Shitësi as nga Blerësi (në bazë të zbatimit të ndonjë ligji ose në ndonjë mënyrë tjetër) pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

7.6 Kjo Marrëveshje është lidhur në gjuhën angleze. Çdo njoftim i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të duhet të jetë në anglisht dhe do të bëhet në përputhje me dispozitat e kryerjes së njoftimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Zgjidhjes me Mirëkuptim.

NË PRANI TË PALËVE, Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shënuar më sipër.

[Blerësi]

Emri: Arben AHMETAJ
Titulli:

Emri:

[Shitësi]


Emri: Jaroslav MACEK
Titulli:

Emri:

Titulli:

ky puthetin eente ne përpjekje me
puthenim e tregimit nr. 6 te Marverges si
permisjonit, certifikates nga ministria e
Sistemeve e Pavarur ligjet 114/2014, dt. 31. 02. 2014

Aleksandri
Rufan Boçeli
Dali



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
MINISTRAT E ENERGJISÉ
DHE INDUSTRISÉ

URDHÉR

Nr. 149, datë 08.5.2016

PËR

TRANSFERIMIN E PRONÉSISÉ SË AKSIONEVE TË SHOQËRISÉ OPERATORII
SHPËRNDAJES SË ENERGJISÉ ELEKTRIKE SH.A, NGA ISH MINISTRAT E EKONOMISÉ,
TREGTISÉ DHE ENERGJETIKAS (AKTUALISHT MINISTRAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISÉ DHE SIPËRMARRJES), NË MINISTRINË E ENERGJISÉ DHE
INDUSTRISÉ, SI PËRFAQËSUESE E PRONARIT SHTET

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 48, pika 2 dhe 53, pika 3, të Ligjit Nr. 32/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, të Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 317, datë 27.4.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin, si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike",



URDHÉROJ:

1. Transferimin e pronësisë së aksioneve të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Elektrike Elektrike Sh.A, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NUIS K72410014H, nga ish Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikas (aktualisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si përfaqësuese e pronarit shtet.

2. Kryerjen e procedurave përkatëse të transferimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe pasqyrimin e tij në regjistrat publik.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI



FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 75

Tiranë – E enje, 5 maj 2016

PËRMBAJTA

Faqë

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 27.4.2016 Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme", 2016–2018 4307

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 314, datë 27.4.2016 Për një shtesë në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagesë të qirasë për disa familje që preken nga zbatimi i projektit "Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti "Komuna e Parisit-Ruga e Kavajes"..... 4318

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 27.4.2016 Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pronës me emërtimin "Klubi Sportiv Dinamo", Tiranë..... 4319

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 316, datë 27.4.2016 Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2016, përbashkësitet febare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave..... 4323

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 27.4.2016 Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike..... 4324

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 318, datë 27.4.2016 Për përcaktimin e autoritetit kontraktor për të ndërmarrë dhe zhvilluar procedurat përdhënë koncesioni/partneritet publik privat, me objekt ndriçimin publik në territoret e njësive administrative vendore, në kuadër të programit të eficiencës së energjisë..... 4324

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 27.4.2016 Për përcaktimin e procedurës e të metodës së testimit të varieteteve..... 4325

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 27.4.2016 Për një ndryshim në vendimin nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"..... 4327

Adresa: Bulevardi "Gjergji Fishta", pas ish-Ekspozites "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006

Fletorja Zyrtare



Viti 2016 – Numri 75

VENDIM

Nr. 317, datë 27.4.2016

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
PUBLIK QË PËRFQAËSON SHTETIN SI
PRONAR TË AKSIONEVE TË
SHOQËRIVE TË SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e 53, pika 3, të ligjt nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe të nenit 4, të ligjt nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike, sh.a., dha Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emrërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon menjëherë pranë Entit Rregulator të Energjisë, përcaktim, sipas procedurës së përcaktuara në nenin 58, të ligjt nr. 43/2015.

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushton të drejtat mbi OST-në, në përpunje me parashikimet e ligjt nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Korporata Elektroenergetike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., dha Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRISÉ

DAMIAN GJIKNURI

18045
03.5.2016

REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 317, datë 27.4.2016

PËR

PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PUBLIK QË PËRFQAËSON SHTETIN SI
PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e 53, pika 3, të ligjt nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe të nenit 4, të ligjt nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike, sh.a., dha Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emrërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon menjëherë pranë Entit Rregulator të Energjisë, përcaktim, sipas procedurës së përcaktuara në nenin 58, të ligjt nr. 43/2015.

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushton të drejtat mbi OST-në, në përpunje me parashikimet e ligjt nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Korporata Elektroenergetike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., dha Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRISÉ

DAMIAN GJIKNURI

18045
03.5.2016

REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
KËSHILLI I MINISTRAVE